

SKIFTER KËLLIÇI

8SH-32

K 50

**SHKALLËT
E MURRME**

TREGIME

8SH-52

8'

K. 50

SKIFTER KËLLIÇI

PERMITENCA R

SHKALLËT E MURRME

(Tregime sportive)

34717

48542

LIJTEKA E SHKËTETIT
GJYKIMOR

SHKËTETI BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

PËRMBYSJA

Skuadra e tyre zbriste në këtë vend jugor në një nga ditët e fundit të dhjetorit. Të gjithë dukeshin të lodhur, mbase dhe të mërzitur. Ndoshta kjo vinte nga udhëtimi i gjatë, ndoshta nga që zhvillonin ndeshjen e fundit të fazës parafinale të kampionatit evropian në futboll, pas një sezoni të gjatë sportiv të mbushur me takime. Duhej hequr qafe dhe kjo ndeshje.

Me ta ishin dhe turistët e fundit, bile më të jashtëzakonshmit, se turistët e fundit kishin lënë plazhin në një ditë të ftohtë vjeshte, kur fletët e zverdhura lëshoheshin në rërën e lagësht e toka dukej se po përflakej.

Po ata nuk vinin të shihnin as detin, as vilat e plazhit, të kredhura në qetësi e harresë.

Ata vinin të shihnin këtë ndeshje futbollit.

Ndonjë rëndësi të madhe nuk paraqiste, sepse, është e kuptueshme, si nënkampionë të botës, pajtjetër do të fitonin dhe kështu vitin e ardhshëm do të vazhdonin turnetë nëpër stadiumet e tjera të Evropës.

Kështu gjykonin futbollistët dhe turistët e huaj, duke shëtitur nëpër rrugët e kryeqytetit me fotoaparate në duar. Kështu gjykonte dhe Adolfi,

një ndër futbollistët më të mirë të nënkampioneve. Ai ecte rrugëve të kryeqytetit, ndalej, shihte përreth, për të shuar kureshtjen.

Para disa ditësh diku, në një krahinë kufitare, kishte rënë një tërmet i fortë, që ishte shtrirë dhe përtej kufirit, duke përmbysur një qytet të huaj. Agjensitë dhe shtypi perëndimor thoshin se në ato krahina të vendit tjetër kishte pështjellim dhe amulli. Jeta andej nuk po normalizohej. Me siguri kështhu do të ishte dhe kënde, sepse tërmetet janë fatkeqësi të natyrës, që nuk mënjanohen mënjëherë.

Pastaj ç'mund të bënte ky shtet i vogël i izoluar?

Adolfi dhe futbollistët e tjerë shihnin kudo maqina që venin e vinin gjatë një rruge anës së hotelit të madh; maqina të mëdha të ngarkuara me njerëz, lëndë ndërtimi; më pas gjithnjë maqina, maqina.

«Ku venë këta njerëz, këto maqina?»

Kështu pyesnin gjithnjë me kureshtjen e një turisti, që kërkon të dijë për gjithshka që sheh. Pritnin të dëgjonin qoftë dhe një fjalë për fatkeqësi, shqetësim, po merrnin vetëm një përgjegje:

«Vijnë nga të katër anët e Shqipërisë. Venë të ndihmojnë zonat e dëmtuara nga tërmeti.»

«Kaq shumë?»

«Edhe më shumë do të vijnë. Brenda muajit do të rregullohet çdo shtëpi e rrëzuar. Të gjitha me shpenzimet e shtetit.»

«Si është e mundur kaq shpejt? Dhe me shpenzimet e shtetit! Po ata përtej kufirit kanë mbetur pa shtëpi!..»

Nëpër rrugë kishte gjallëri. Po kjo nuk vinte vetëm nga ndeshja që do të zhvillohej. Ato ditë Qeveria dhe Partia Komuniste e këtij vendi kishin vendosur që, brenda vitit 1971, të elektrifikonin gjithë fshatrat. Adolfit pak i interesonte kjo, megjithëse habitej, kur mësonte se kjo punë do të kryhej 14 vjet përpara planit të parashikuar.

Johanin me Zigfridin, dy miq të tij turistë, që e kishin shoqëruar në të gjitha ndeshjet, i shihte tek qëndronin shpesh në hollin e hotelit. Ai e dinte se ata vetëm për ndeshjen bisedonin.

«Apo jo, Johan? Do të fitojmë?»

«S'ka dyshim.»

«Po me ç'rezultat thua ti?..»

Dhe kështu ata kalonin kohën, duke bërë parashikime për ndeshjen që do të zhvillohej.

* * *

Shkallët e stadiumit të vogël, por të bukur, pranë kodrave të blerta, qenë mbushur me kohë.

«Janë sportdashës me temperament, për më tepër se do të shohin nënkampionët e botës», tha Adolfi me vete, duke u bërë gati të hynte në fushë.

Kurse atje në shkallë Johani dhe Zigfridi, si gjithë turistët e tjerë, vazhdonin bisedat e gajaseshin.

Pastaj në fushë dolën futbollistët. Johani dhe Zigfridi i bënë shenjë me dorë Adolfit, që ndodhej aty diku në fushë, pranë tribunës qendrore. Edhe Adolfi u bëri shenjë me dorë. Ai e ndjente veten të qetë. Pa turmat në shkallët e murme, gërmat e mëdha e të kuqe nën shkallët dhe vuri

buzën në gaz me përçmim. E dinte që ato ishin parulla. I kish parë dhe rrugëve. Ja kishin shpjeguar: «Gati për punë dhe mbrojtje», «Në një dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën».

«Shqiptarët janë vigjilentë», tha me vete. «Po këtu, me çfarë do të mbrohen këtu?»

Pas pak do të fillonte ndeshja. Tani futbollistët shqiptarë, të veshur me fanella të kuqe, qenë renditur në fushë përballë tyre. Ato çaste Adolfi solli ndërmend Konradin, një tifoz të rrallë, që e kish shoqëruar skuadrën e tyre në çdo ndeshje si Johani me Zigfridin.

Po këtë radhë Konradi nuk kishte ardhur.

Çfarë psikopati! U kishte thënë se në Shqipëri është vështirë të fitosh, sepse edhe skuadra të tjera nuk kishin fituar atje; as kampionja suedeze, skoceze, bullgare, bile as kampionja e vendit të tyre.

«Eh, Konrad, harron ti se ne jemi nënkampionët e botës? Do të fitojmë!»

«Kështu gjykonin dhe ata të Irlandës së Veriut, po e pësuan atje».

«Jemi nënkampionët e botës, Konrad!»

Po Konradi s'kishte ardhur dhe për një arësye tjetër: gjatë viteve të luftës ai kishte qenë ushtar në viset e këtij vendi. Adolfi sillte ndër mend tregimin e tij:

«...Një herë ne sulmuam një grup të madh partizanësh. Po i rrethonim në një darë të hekurt. S'kishin nga të gjenin shteg shpëtimi. Po ata nuk po dorëzoheshin, ndaj duheshin asgjësuar. Dhe ne ashtu vendosëm...»

Adolfi nuk pati kohë të mendohej më gjatë, se atë kohë filloi ndeshja.

* * *

Ai nuk e mori vesh se ç'ndodhi. Qe një gjë e pakuftueshme, si një ëndërr. Kundërshtarët ishin hedhur në sulm, sikur para tyre të mos ndodhe-shin nënkampionët e botës, që kishin fituar në sa e sa stadiume.

Solli ndër mend Konradin, që atje larg në at-dhe me siguri qe mbërthyer pranë radios.

«Ju thashë, shqiptarët janë të rrezikshëm në fushën e tyre!»

«Do të kalojë, Konrad. Kështu ndodh jo rrallë me skuadrat e vogla. Po do të bien pastaj».

Adolfi u shkund, si të zgjohej nga një gjumë i frikshëm. Johani dhe Zigfridi u panë sy më sy. Edhe turistët e tjerë në shkallët e stadiumit. Fusha dukej se po shtrydhej në vorbullën e britmave, që e mbështillnin nga të katër anët.

Kaluan njëzet, tridhjetë minuta dhe ata nuk po shkuleshin dot nga gjysmëfusha e tyre.

Për një çast Adolfi u drodh. Portieri i tyre mezi kapi një top, që për pak po kalonte vijën e portës. Bile topi kish kaluar tutje vijës; mbylli sytë, po gjyqtari, si për çudi, dha shenjën që loja të vazhdonte.

Dhe loja vazhdoi, ndërsa ai dhe të tjerët në fushë dukeshin herë të ndrojtur, herë nervozë sikur luanin për herë të parë.

— E nisën keq, Zigfrid, por do të qetësohen.

— Patjetër që do të qetësohen, Johan. Pastaj do të dinë si do të luajnë.

«Vërtet tani gjithshka do të kalojë. E çuditshme si ndodhi kështu, që këta me fanella të kuqe të luajnë kaq mirë sot».

Duke menduar kështu, Adolfi, që endej pranë zonës së rreptësisë së tij, u bëri shenjë shokëve të suleshin përpara.

«Thua të ketë të drejtë Konradi?»

«Po, po, Adolf, — i dukej se i tingëllonte nga afër zëri i Konradit. — Duhet t'i kesh kujdes të kuqtë. Ti që i sheh si sulen, e kupton mirë. Fanelat e kuqe! Atëhere kishin yj të kuq, shami të kuqe. Ne atëhere mbetëm diku midis shkrepash. Nuk mund të bënim asnjë hap përpara. Ata na qëllonin befasisht nga mundnin e ne nuk dinim nga të qëllonim. Ruhuni nga sulmet e tyre të befasishme».

Adolfi ndjente se si vallja e lojës po luhej gjithnjë në gjysmëfushën e tyre, e shpejtë, e vrullshme, kërcënuese, bile tronditëse nën ritmin e britmave, që s'kishin të sosur.

Dhe kjo valle mbaroi, kur mbaroi pjesa e parë.

— Epo s'ka gjë, Johan. Kemi dhe dyzet e pesë minuta të tjera. Janë gjëra që ngjasin në futboll.

— Po, po, Zigfrid. Vetëm një gjë ka rëndësi. Sot nuk do të fitojmë me rezultat të thellë.

— Të fitojmë, vetëm të fitojmë. Paska pasur të drejtë Konradi.

«Sigurisht që kam pasur të drejtë. Në tokën e tyre ata janë të papërmbajtshëm. Adolf, çështja është të mos humbni».

Adolfi vështroi ngultas kundërshtarët me fanella të kuqe, që kishin dalë rishtas në fushë, shokët e tij të skuadrës, që tani dukeshin më të qetë.

Me të filluar puna e dytë, u hodhën në sulm.
— Më në fund! — tha Johani.

— Po, po, më në fund! — tha dhe Zigfridi.

Të dy morën frymë thellë, aq më tepër se të kuqtë po luanin me dhjetë veta, sepse njeri prej tyre ishte plagosur e mezi lëvizte në fushë.

Mirëpo...

Në fushë po përsëritej pamja e pjesës së parë.

— Tersllëk — tha Johani.

— Vërtet tersllëk i madh — tha Zigfridi. — Shikoje Adolfin sa është lodhur.

Adolfi gulçonte në fushë. Ai ndiqte të kuqtë, përpiquej t'i ndalte, po ata i shkisinin si hije. Sidomos njëri prej tyre nuk përmbahej. Kurse ai kishte përmbajtur sa e sa të tillë në gjithë stadiumet e Evropës.

«Është e pamundur të fitojmë sot. Mjaft dhe barazimi», i shfaqej si nëpër ëndërr jehona e zërit të Konradit.

Ai u drodh.

«Po të barazojmë, do të thotë të mos dalim në finalet e kampionatit evropian. E kush, ne, nënkampionët e botës! Si është e mundur!»

U shkund dhe bëri përpara. Tani vetëm përpara.

Johani dhe Zigfridi filluan të thërrasin. U dëgjuan, edhe zërat e turistëve të tjerë, që dukeshin të nemitur. Po ata u pështollën dhe humbën në vorbullën e brohoritjeve, që vërshenin nga shkallët, aq sa Adolfi dhe futbollistët e tjerë nuk mundën të dëgjonin asgjë.

Johani deshi të nxirrte dhe flamurin e ta vavlaviste në fushë. (Ai e kishte bërë zakon që në çdo ndeshje jashtë shtetit ta mbante me vete, po mbe-

ti). Vallja e lojës po endej gjithnjë kërcënuese në fushën e tyre.

Ata kishin mbetur si të ngrirë. Qe një çast kur njëri nga të kuqtë gjuajti fort e topi fluturoi si predhë sipër portës.

Stadiumi lëshoi një pasthirmë.

Johani dhe Zigfridi morën frymë.

«Shpëtuam dhe këtë radhë» mendoi Adolfi, që gjeti rast të pushonte ca, derisa topi të vihej përsëri në lojë.

«Ashtu tamam, shpëtuam» iu duk se dëgjoi zërin e Konradit. «Dhe atëhere mezi patëm shpëtuar. U futëm thellë një pylli e menduam se do t'i zhduknim me lehtësi. Kur papritur u gjetëm të rrethuar. O, tmerr! Si ishte e mundur! Ne që po i rrethonim ata! Në ç'grackë kishim rënë! Ishte me të vërtetë e llahtarshme. Nuk dinim si të mbroheshim se plumbat na fëshkëllenin nga të gjitha anët.»

«Po ne si të mbrohemi tani?» tha Adolfi me vete, duke parë fytyrat e inatosura të shokëve të tij. Tani donte që ndeshja të përfundonte sa më parë.

Sulmet e dëshpëruara të nënkampionëve mezi zvarriseshin deri afër portës së të kuqve pa forcë, si valë përtaçe.

«Ç'është kjo, ç'po ndodh kështu? Kaq e papritur, kaq e pabesueshme. Ku i gjetën këto forca? Kjo i ngjet tamam një ekzaltimi. Po si ndodhi kjo?»

Duke bluajtur këtë mendim, Adolfi solli ndërmend rrugët e zhurmshme, njerëzit, maqinat, gjallërinë dhe harenë për dritat që do të përhapeshin në tërë Shqipërinë.

Të kuqtë përsëri po sulmonin.

«Sikur po na rrethojnë».

Adolfi pa se si të kuqtë po dyndeshin drejt portës së tyre.

«Kështu na patën rrethuar dhe atëhere, tek mendonim se i kishim shtënë në darën tonë. Ç'ke-mi hequr! S'dinim nga t'ja mbanim nën breshërinë e plumbave. Sa shumë u vranë! Unë dhe disa të tjerë mezi arritëm të shpëtonim. Po ju, ju si do të shpëtoni?».

«Edhe pak dhe do të shpëtojmë...» i dha zemër vetes Adolfi, teksa të kuqtë po i shtrëngonin pranë portës. Iu duk se diçka e kuqe lëshohej nga flamujtë rreth stadiumit, nga gërmat e mëdha të parullave, nga fanellat e kuqe; shpërthente flakë e ato po i përzhitnin, po u merrnin frymën.

Kur topi u largua nga gjysmëfusha e tyre, ai u mundua të shquante Johanin dhe Zigfridin e turistët e tjerë që donin të dilnin nga stadiumi po e pat të vështirë, se turmat qenë ngushtuar si një gardh i stërmadh, që po i ndrydhte gjithnjë e më shumë.

«E kupton përse nuk kam ardhur në këtë vend, Adolf? S'mund ta harroj atë që ka ngjarë atëhere. Dhe ja, pas kaq vjetësh, po përsëritet një diçka e ngjashme me atë. E parandjeja. Mjerë ju atje në fushë».

Adolfit iu duk se flakët e kuqe po përpinin tërë stadiumin që po lëkundej nga entuziazmi, duke përmbysur thellë gjymtyrëve të tij gjigande ata vetë, nënkampionët e botës, që në këtë stadium, megjithëse po e ruanin portën të paprekur, kishin pësuar disfatë.

SHPRESA TË VENITURA

Musllum beu zbriti nga maqina.

Rruga kish qenë e shkurtër, por megjithatë e kish lodhur. Ndoshta kjo vinte nga vapa e madhe, ndoshta nga që ai kish ngrënë shumë (hej drej, sa herë ishte betuar që të lironte rripin deri në vrimën e tretë, po aq herë e kishte shkelur këtë betim, edhe sot, kish ngrënë aq, sa kish zbërthyer dhe kopsën e sipërme të pantallonave).

Ai pa rreth e rrotull zonja e zotërinj të veshur si për festë. Po, po, i duhej dhënë rëndësi inaugurimit të parkut sportiv, ashtu si çdo inaugurimi tjetër, në të cilin ai kishte marrë pjesë.

Ndaj ndonëse e ndjente veten të rënduar dhe gromësimat i delnin njera pas tjetrës, Musllum beu ngriti kokën e, duke i dhënë fytyrës një pamje të qeshur, eci me hapa të mëdha përpara.

Zonjat e zotërinjtë duartrokitën, duke nderuar plot elegancë me përkulje të lehta të kokës.

Një burrë, ca i shkurtër, i mbuluar i tëri në djersë, nxitoi dhe iu afrua Musllum beut. Ishte inxhinieri i punimeve.

— Këtu, pra, do të ndërtohet parku? — pyeti Musllum beu.

— Këtu, shkëlqesi, — u përgjegj inxhinieri.
— Si ju duket vendi?

— I bukur. S'bëhet më mirë.

Përreth Musllum beut dhe inxhinierit u afruan zonjat dhe zotërinjtë. Tani të gjithë së bashku, të ndjekur nga turma e të rinjve, po drejtoheshin te vendi ku do të zhvillohej ceremonia. Midis tyre ishte Genci dhe Luani. Ata ndjenin një gëzim të rrallë: do të ngrihej parku sportiv. Skuadrat e të rinjve nuk do të endeshin më andej-këndej.

— Gjithë këtë fushë do përfshijë parku? — pyeti përsëri Musllum beu.

— Po u përgjegj inxhinieri.

— Si shumë më duket!

— Jo dhe aq, Musllum bej. Kjo do të jetë fusha e futbollit.

— Ç'rëndësi ka. Mund të bëhej më e vogël. Inxhinieri mbeti ngushtë.

— Më falni, po nuk ka si bëhet — u mundua të sqarojë. — Futbolli luhet me nga njëmbëdhjetë lojtarë për çdo skuadër.

— E pastaj? S'bën të luhet me nga shtatë vetë? Ma thotë mendja se do të ishte dhe më bukur.

Zotërinjtë për një çast u shikuan sy më sy, po shpejt e mblodhën veten dhe filluan t'i çojnë buzët vesh më vesh, duke aprovuar me lëkundje të kokës këto fjalë të Musllum beut.

— Mendim i goditur vërtet!

— S'ka si bëhet më mirë. Edhe futbollistët nuk do të lodheshin duke i rënë vërdallë fushës.

— Edhe ne do të shikonim më mirë.

Luani dhe Genci s'po merrnin vesh asgjë nga këto biseda.

Inxhinieri rrotulloi sytë dhe kundroi i hutuar, po shpejt e mblodhi veten e u gjallërua:

— Sa bukur e thatë, Musllum bej. Ja, kjo nuk më kish shkuar kurrë në mend. Dhe qenka kaq e thjeshtë! — tha inxhinieri duke fshirë djersët, që i kullonin në ballë, me sa duket më shumë nga sikleti se sa nga vapa. — Po si të them, kjo do bërë në të ardhmen... të kuptohemi, fushat e qyteteve tona kanë të gjitha një madhësi, kështu që ka vështirësi që të realizohet ky mendimi juaj i goditur, Musllum bej.

— Vërtet ka vështirësi? — u habit Musllum beu. — Mirë, mirë, ju jeni të zanatit; le të mbetet për të ardhmen. Megjithatë rriheni dhe mendimin tim.

— Patjetër — tha me zë të zvargur inxhinieri duke u munduar të qeshë.

— Në një të ardhme sa më të shpejtë. T'i bëjmë dhe një propozim FIFA-s — tha dikush.

— Ç'është kjo FIFA? — pyeti Musllum beu.

— Federata Ndërkombëtare e Futbollit. Do ta quajnë si një shpikje gjeniale.

Zonjat e zotërinjtë përsëri qeshën. Qeshi dhe Musllum beu.

— Po kësaj ç'i thonë — pyeti me zë të ulët Genci Luanin.

— Injorancë e turpshme, — tha Luani duke shikuar me përbuzje zonjat dhe zotërinjtë që gajaseshin. — Çdo gjë mund të presësh prej tyre.

— Jo, të them të drejtën, këtë nuk e prisja. Megjithatë s'kemi pse shqetësohemi; ja arritëm më në fund ditës që të marrim pjesë në inaugurimin e një parku sportiv.

Ata e ndërprejnë bisedën, sepse në atë kohë u dëgjua të fliste Musllum beu.

— Zonja dhe zotërinj! Sot ne jemi dëshmitarë të një veprë të re që po i shtohet qytetit tonë, par-
kut sportiv».

Fjalën e tij e ndërprejnë duartrokitjet.

— Kjo tregon, — vazhdoi Musllum beu, — kujdesin e madh të Lartmadhërisë së tij, që i qofshim falë, për rininë tonë, e cila do t'i mbetet gjithmonë e devotshme. Ne e dimë se shteti ynë harxhon shuma të mëdha për ndërtime. Kujtoni vetëm disa nga veprat e ndërtuara kohët e fundit dhe do të bindeni vetë: brenda një kohe të shkurtër përfundoi karabinaja e burgut të Burrelit, një burg modern nën dhe, ndër më të mirët në Ballkan e, pse jo? në Evropë...

Përsëri u dëgjuan duartrokitjet.

Luani dhe Genci ngritën supet, ndërsa Musllum beu, duke bërë shenjë që të mbahej qetësi, vazhdoi të ligjërojë:

— Ose le të marrim të tjera vepra: të tilla janë për shembull nevojtoret publike të xhamija, që zgjidhin një problem të madh për qytetarët, të cilët... mund... (në këto e sipër nga fundi u dëgjuan të qeshura. Musllum beu vuri buzën në gaz, duke pandehur se fjala e tij kish ngjallur entuziazëm, por shpejt u kujtua se më tej s'kish si ta vazhdonte këtë frazë, andaj fytyra e tij mori një pamje serioze) ... ose le të marrim hamamet, apo banjot publike, si i quajnë. Pse, mos janë të pakta këto? ..

Zonjat dhe zotërinjtë pohonin me kokë, duke u munduar t'u jepnin një shprehje të hareshme

fytyrave të tyre, që edhe sikur të ishin lyer me vaj, zor se do të shkëlqenin ashtu, aq shumë qenë dërsirë.

— E kush mund t'i numërojë veprat që janë ndërtuar drejtpërsëdrejti me urdhër të Lartmadhërisë së tij, të cilit i falshim nga jeta jonë!

Këtë radhë duartrokiti i pari e u mundua t'i jepte gjallëri ambientit të dëgjonjësve.

— Pse, të pakta janë kafenetë që janë hapur? Ka lloj-lloj kafenesh. Që nga ato allaturkat e deri tek ato allafrangat, që të japin kafënë në dorë, pa hapur mirë gojën. Pa më thoni, ç'do të bënte miletë po të mos ishin këto kafene? Hiçgjë s'do të bënte. Do të sillej vërdallë e do të vriste miza.

— Mos është dehur ky? — tha Luani.

— Lere, ç'ke me të, ç'mund të presësh më tepër prej tij, — u përgjegj Genci.

— Mirë që iu ndërrua mendja, se do ta kish marrë lumi fushën.

— Do të kishte qenë e tmerrshme.

— Edhe qesharake. Gjyko një herë ç'i pjell rradakja: të luhet futbolla me nga shtatë lojtarë!...

— Ose le të marrim për shembull ndërtimin e këtij parku sportiv — vazhdoi Musllum beu — Do të kënaqet e shkrihet rinia në fushë. Pastaj do të futet në një godinë moderne me dush të ftohtë e të ngrohtë, si t'ja dojë mideja, që i thonë pas... pas...

— Palestër —tha me zë të ulët inxhinieri.

— Hëm, palestër, — përsëriti Musllum beu këtë radhë me siguri. — Në këtë palestër atyre do t'u krijohet çdo mundësi për të qenë rahat, pasi janë bërë telef në fushë. Do të ulen plot

salltanet, do të freskohen duke pirë a ngrënë, e duke bërë kokrrën e qejfit.

Andej nga fundi u dëgjuan përsëri të qeshura. Zonjat dhe zotërinjtë deshën të duartrokasnin që të mbysnin disa thënje plot shpoti, që vinin andej nga fundi:

— Ç'është kjo kafehanë kështu në parkun sportiv?

— Ne duam palestër e jo mejhane.

Musllum beu i shqeu sytë sa një filxhan.

Inxhinieri i gjallë dhe i shkathët si gjithmonë, këtë radhë, si të ishte jo më sufler, po regjizor i kësaj skene, i shpjegoi Musllum beut, natyrisht jo pa delikatesë, përse do të vlente palestra.

— Pse, nuk mjafton fusha për këto punë? — pyeti Musllum beu duke u vrënjtur.

— Si t'ju them, Musllum bej. Edhe nuk mjafton. Janë veglat gjimnastikore e disa lloj sportesh që luhen atje brenda, kur bie shi.

Musllum beu s'e mori vesh se përse duhej me domosdo të luheshin këto lojëra kur binte shi, po, duke u kujtuar që kish lënë ligjëratën përgjysmë, vazhdoi:

— Dua t'ju them, zonja, zotërinj të nderuar ... se në këtë palestër rinia do të bëjë pallë e do të shembet duke luajtur, pa pasur frikë se jashtë bie shi a dëborë, a bëhet kiameti. Dhe ajo që ka rëndësi, qejf pa para, e kuptoni, pa para! Kjo është gjë e madhe, për allah, kurse shteti, të mos harrojmë, do të harxhojë paratë e dynjasë për këtë vepër: rreth 50-mijë franga.

Në turmë u dëgjuan pëshpëritje:

— Ç'patën? — pyeti Musllum beu, që tani po ndjente veten më siklet.

— Kjo është vetëm shuma fillestare, shkëlqesi, — korigjoi gjithnjë i vemendshëm inxhinieri.

— Pse, do të bëhen ende shpenzime?

— Edhe 250-mijë franga, Musllum bej.

— Po kjo kushtoka një djall e gjysmë — tha duke turfulluar Musllum beu. — Pse, qeveria do t'i harxhojë të gjitha këto?

— Jo, Musllum bej! Janë dhe shoqëritë sportive. Të gjithë sportdashësit kanë dhënë jo pak si kontribut për ndërtimin e këtij parku.

Musllum beu, që tani e ndjente veten të lodhur, bëri dhe një përpjekje të madhe për të ruajtur seriozitetin e këtij fjalimi:

— Kështu, pra, zonja e zotërinj, veç këtyre që thashë, do të harxhohen edhe të tjera para e kjo vepër, që ndërtohet me kujdesin e Lartmadhërisë, do të zbukurojë qytetin tonë, do të gëzojë dhe rininë, që edhe këtë radhë nuk është kursyer të ndihmojë me paratë e saj...»

Musllum beu u përkul me një nënqeshje të shtirur. Të pranishmit duartrokiten, morën frymë thellë e fshinë fytyrat e qullura.

— Ama, ç'na përrallosi! — tha Luani që mezi kishte përmbajtur veten.

— Më së fundi mbaroi; shpëtuam — tha Genci. — Qe diçka e pështirë. Po një gjë duhet të na ngushullojë. Parku më së fundi do të ndërtohet.

— Vetëm të shohim se kur — shtoi Luani.

— Ku vini, ku vini kështu?

Inxhinieri, duke u tundur si një rosak, u doli përpara Gencit dhe Luanit, që po ngjiteshin në skelat e godinës.

— Ç'po bëhet këtu? — pyeti Luani.

— Ama pyetje! Ndërtohet, —u përgjegj inxhinieri. — Po ju kush jeni, përse keni ardhur?..

Po Luani, pa iu përgjegjur pyetjes së tij, tha:

— Çfarë po ndërtohet, ç'është kjo godinë dykatshe?

Toni i ashpër e habiti inxhinierin. Ai ose pa ndehu se Luani që ndonjë kureshtar, nga ata që shqiten vetëm kur mësojnë atë që duan, ose e morri për ndonjë nëpunës të bashkisë, megjithëse nga paraqitja Luani s'shembëllente si i tillë. Megjithatë, duke përkulur kokën lehtë dhe duke u ëmbël-suar në fytyrë, sa do t'ja kish zili hipokriti apo servili më i madh, tha me ton të butë:

— Kini të drejtë. Po ndërtojmë një bar-kafe.

— Bar-kafe?!

— Po, po bar-kafe. Do të jetë diçka madhështore, diçka... .

Luani mezi e përmbajti veten.

Po këtu do të ndërtohej një park sportiv?!

— Vërtet kështu ishte në fillim, po pastaj u ndryshua plani.

— Kush e ndryshoi këtë plan?

— Musllum beu.

Luani përkuli kokën sikur të kishte pësuar një goditje në zemër.

— Si është e mundur! ...

— Qetësohu, Luan; çdo gjë është e mundur me këta — tha Genci. — Ti kishe të drejtë.

— Po në fushë ç'po bëhet? — pyeti Luani me zë të dridhur.

— Edhe në fushë po bëhen ndërtime. Ushtria do të ngrejë një kazermë.

— Kazermë, dëgjon, Genci? Po ndërtojnë kazerma, aty ku do të ndërtohej parku ynë psortiv...

Inxhinieri, duke dëgjuar këto fjalë, kryqëzoi duart në gjoksin e tij, që ngrihej njësh me barkun e foli me një ton të rëndë:

— Po cilët jeni ju, në fund të fundit, që më kërkoni llogari?

— Kërmill! — briti Luani, aq sa inxhinieri u mblodh vërtetë si kërmill që tkurret në guackën e tij. — Duhet vajtur tek ai, te Genci.

Dhe, pasi e tërhoqi shokun për krahu, kaloi tutej fushës duke lënë inxhinierin të tronditur.

* * *

— Pot.

— Visto.

— Pas.

— Kartë.

Musllum beu, duke rrotulluar nëpër gojë një cigare të fikur, vështronte letrat e bixhozit, vështronte dhe kundërshtarët e tjerë, që kishin mbetur të nemitur me sytë të ngulur te pingu i parave që kish fituar. Nga fundi i sallës së madhe të kafesë vinin tingujt e një tangoje. Zonjat e zotërinjtë pinin cigare dhe bisedonin.

Musllum beu po fitonte. Dhe, kur fitonte, s'do mend që ishte me qejf, megjithëse, edhe kur hu-

mbte, nuk e bënte qejfin qeder, se kurrë nuk kishte lënë në tryezën e pokerit paratë e tij.

Edhe këtë radhë i kishte vënë përpara kundërshtarët me fytyra të vrazhda, që zbeheshin dhe nxeheshin nga ethet e lojës.

S'kaloi shumë dhe, me të mbaruar seancën e fundit, Musllum beu u ngrit, rrëmbeu me duart e trasha grumbujt e parave, i ndjekur nga vështtrimet ziliqare të atyre që ua kish fituar, i rراسi ato si munda nëpër xhepe dhe u ngrit të dilte jashtë.

Ai po zbriste shkallët e jashtme të kafesë, kur papritur dëgjoi ta thërrisnin:

— Musllum bej! ...

Përpara tij qëndronte Genci me Luanin. Ai ish mësuar të shihte njerëz nga populli, që vinin për t'i qarë ndonjë hall. Bile krekosej, u afrohej me përzemërsi, i dëgjonte me vëmendje, për t'u dukur para zonjave e zotërinjve, që flisnin me miratim për filantropizmin e tij, tek shihnin të nxirrte nga xhepi, ndonjë para për t'ua dhënë atyre. Kështu që, me të parë Gencin e Luanin, duke futur dorën në xhepin e jelekut, tha:

—Për ç'hall kini ardhur, bijtë e mi? Flisni ç'ju ka ngjarë.

— S'ka shumë kohë që ju muarët pjesë në inaugurimin e punimeve të parkut sportiv — tha Luanin.

— Po — u përgjegj i habitur Musllum beu.

— Kurse atje po ndërtohet një bar-kafe, ndërsta në fushën e futbollit po ngrihet një kazermë. Ju kini urdhëruar?

— Aha, e mora vesh — nisi të flasë Musllum beu

dhe u zbut në fytyrë. — Ju jeni sportistë, apo jo?

— Po.

— E kuptoj, e kuptoj, sportistë me vullnet, me dëshirë, me ëndërra. Po çdo gjë ka kohën dhe vendin e vet, bijtë e mij. Edhe parkut sportiv do t'i vijë dita. Po u bë një gabim; u nxituam. Mileti ka qejf për gjëra më të bukura, më të këndshme se sporti. Andaj dhe ne vendosëm që të ndërtojmë së pari një bar-kafe, ku të kënaqen të gjithë. Mos u habitni. Edhe atje do të ketë dëfrime për ju. Po, do të ketë bilardo, tavllë, domino.

— Edhe tryeza për poker ...

— Sigurisht edhe tryeza për poker. Mund të vëmë dhe lodra të tjera, mund të bëjmë edhe kampionate. E pse jo? Mvaret nga dëshira e të rinjve. S'do mend që do të ketë dhe muzikë. Qeveria i ka marrë parasysh të gjitha shpenzimet — vazhdoi të dërdëllisë Musllum beu pa e kuptuar ironinë e fjalëve të Luanit.

— Po paratë e shoqërive sportive ç'u bënë?

— Paratë tuaja? ...

Musllum beu mbeti gojëhapur, siç kishin mbetur dhe disa njerëz, që, duke hyrë e dalë, qëndronin të dëgjonin këtë bisedë.

— Paratë tuaja janë shkruar me fondet e qeverisë. Nuk kini dalë të humbur — tha pastaj Musllum beu. — Po në qoftë se ju të dy kini nevojë për ato para, unë mund t'juaj kthej.

Musllum beu nxori nga xhepi disa kartmone-dha dhe u mat t'ua jepte Luanit dhe Gencit.

— Ju na gënjet — tha me përbuzje Luani, duke i hedhur atij një vështrim të egër.

— Si guxoni ju rrjepacakë! — ulëriu Musllum beu, ndërsa në fytyrën e tij u zhdruk çdo shenjë butësie e miratimi të shtirur

Nja dy-tre njerëz përreth, me të dëgjuar zërin e Musllum beut, u sulën dhe filluan të shtyjnë Luanin me Gencin.

— Mashtronjës! — thirri Luani, me zë të dridhur nga urrejtja, ndërsa Genci mundohej të qetësonte shokun e tij.

Musllum beu e mblodhi shpejt veten dhe ti-paret e tij filluan sërishmi të zbuten.

Rreth tij qenë mbledhur gra e burra.

— Asgjë, zotërinj të nderuar, s'ka asgjë për t'u shqetësuar. Pandeja se mos ishin hallexhinj, po ja që na dolën dy të çmendur. Ç'të bësh, ndodh edhe kështu. Po vazhdoni, vazhdoni qejfin tuaj — tha dhe nisi të zbrësë rëndë-rëndë shkallët e kafenesë.

Zonjat e zotërinjtë, që kishin mbetur të shushatur, buzëqeshën, gati sa s'rrahën shuplakat për humorin e mirë të Musllum beut dhe vazhduan bisedat e pambaruara për modën, për shetitjet dhe, s'do mend, edhe për bar-kafenenë e re, që do të ngrihej në vend të parkut sportiv, në inaugurimin e të cilit kishin marrë pjesë plot entuziazëm atë pasdite të nxehtë vere.

KTHIMI

Turmat po i afroreshin sheshit «Avanti». Bardhyli i pa tek po dilte nga stadiumi. Ai sapo kishte mbaruar stërvitjen e zakonshme dhe tani po kthehej në konvikt.

Në krye iu dukën pak njerëz, po, sa më shumë ecte, aq më tepër haste grumbuj të tjerë, që shkriheshin e ngjisheshin me valën kryesore e cila tani po përpinte sheshin.

«Ku venë këta kështu?» mendoj me vete. Ai pa se aty qenë rrjeshtuar ushtarë të rinj, që do të niseshin për në Shqipëri. Ata që grumbulloheshin, siç duket, qenë prindërit dhe vëllezërit e ushtarëve.

— Hej, Bardhyl! — dëgjoi një zë nga turma.
— Ç'më rri ashtu. Eja dhe ti me ne!

Ktheu kokën dhe pa Xhovanin, një student të Institutit të kulturës fizike që ishte bashkuar me turmën.

Por Bardhyli bëri sikur nuk dëgjoi. Eci përpara, duke e lënë të topitur Xhovanin, që po humbiste në mes njerëzish. Më tutje pa dhe studentë të tjerë. «Mbase duan të bëjnë ndonjë demonstratë» tha me vete.

Turmat u grumbulluan në qendrën e sheshit, ndërsa Bardhyli u përpoq të çante më tej. Por që e pamundur. Njerëzit qenë ngjeshur njëri pas tjetrit.

Ai mori të kthehej nga ana e kundërt, studentët shqiptarë nuk po i zinte syri. Ndoshta ishin diku midis turmës gjigande. Po një pjesë e mirë e tyre kishin lënë Italinë disa ditë më parë, pas thirrjes së Partisë Komuniste Shqiptare, që sapo ishte formuar dhe ishin kthyer në atdhe.

Solli ndër mend Farukun, që e kish takuar të ngrysur e gojëkyçur disa ditë më parë, kur po dilte nga fusha e stadiumit. Kurse ai vetë ishte tërë gaz, se kishte luajtur shumë mirë dhe ishte duartrokitur nga tifozët. Atij i tingëllonin copat e shkëputura të fjalëve të Farukut, të thëna me rrëmbim të madh:

«Bukur, Bardhyl! Të duartrokitën. S'ke ç'thua. Besoj se je i kënaqur. E pse jo? Të lumtë! Këtu fashistët me rroba të zeza duartrokasin, kurse atje në Shqipëri vrasin, Bardhyl...»

«Vrasin armiqtë e tyre, ata që i luftojnë».

«Vrasin popullin...»

Britmat e turmave e përmendën. Dikush po fliste:

— Nuk mund të durohet më ky mashtrim. Bijtë tanë po dërgohen mish për top në Shqipëri, gjoja për të ruajtur rendin dhe qetësinë nga disa elementë keqbërës, që kanë ngritur krye. Po ata nuk janë keqbërës, ata janë luftëtarë të lirisë së atdheut të tyre. Më thoni, a nuk kanë të drejtë të na urrejnë e të na luftojnë?..»

Turma buçiti. Bardhyli orvatej të çante gjith-

një përpara përmes radhëve të shtrënguara të njerëzve. Zëri i atij që fliste po humbiste dalëngadalë si një oshëtimë e mbytur.

Fashistët nuk po silleshin keq me brezin e ri gjykonte Bardhyli. Fëmijët shqiptarë po trajtoheshin mirë. Gjatë verës mbaheshin në shtëpi pushimi. Një pjesë e tyre, me të mbaruar shkollën e mesme, mund të ndiqte studimet e larta në Itali. Ja, atij vetë, bir i një familjeje të varfër, i kishin siguruar bursë dhe ai kishte vajtur të studjonte në Itali. Edhe këtë kish dëgjuar se e quanin demagogji. Mirëpo nuk mund të ishte kështu. Atij vetë, për shembëll, po i hapej një e ardhme e shkëlqyer. Duke qenë një futbollist i mirë, kish mundësi së shpejti të luante në skuadrat më të mira italiane. Veç të tjerave, do të fitonte dhe para. Kishte gjë më të madhe se kjo?

Po biseda me Farukun i sillej gjithnjë në mend:

«Bardhyl, kanë ardhur kohë të tjera. Partia Komuniste u bëri thirrje intelektualëve dhe studentëve jashtë shtetit».

«Unë nuk merrem me politikë, Faruk».

«Ti je djalë i ndershëm i një familjeje të varfër. Duhet të gjykossh mirë».

«E kuptoj, po nuk dua të rrezikoj të ardhmen time».

«Përse vallë ne nuk mendojmë për këtë të ardhme? Por duhet të dish se ajo sigurohet vetëm kur atdheu të jetë i lirë...»

Tani, duke çarë përmes turmës, atij i tingëllonin gjithnjë e më fort fjalët e Farukut.

Zëri i atij që fliste po tretej dalëngadalë. Tur-

ma shtyhej dhe më përpara për të dëgjuar sa më mirë, kurse ai po largohej gjithnjë më shumë.

Diku i zunë sytë disa karabinierë fashistë. Ata po nxitonin drejt sheshit.

«Mirë që u largova», tha me vete. «Ata tani do të turren të shpërndajnë turmën.»

Bardhyli shpejtoi hapin. Në kthesën e rrugës, papritur u përplas me një oficer të gjatë fashist. Deshi t'i kërkojë ndjesë, po oficeri, pasi i hodhi një vështrim të shpejtë, vrapoi me nxitim. Pas tij dhe disa ushtarë; ndërsa rrugëve buçisnin motocikletat e bersaljerëve.

U largua me hapa të shpejta.

Që nga larg u dëgjuan britma. Ato shtoheshin gjithnjë e më shumë. Pastaj ulurima. Bardhyli u drodh dhe mbeti disa çaste i shtangur.

«Ç'po ngjet kështu?» tha me vete.

Ca më pas u dëgjuan krisma, që u përcollën nga klithma.

«Mos është vrrarë njeri? Jo, nuk është e mundur. Po krismat? Mbase ata kanë shtënë kuturu, për të trembur turmën. Ndryshe nuk ka si të jetë...»

Në këto e sipër ai pa grumbuj njerëzish që po shpërndaheshin me panik anës së rrugëve, të ndjekur nga karabinierët. Disa bersalierë me kamxhikët, që mbanin në duar, qëllonin majtas e djathtas si të xhindosur.

«Përse i qëllonjë? Ata po shpërndahen vetë!»

Bardhyli nuk kishte parë kurrë skenë të tillë. Fashistët qenë egërsuar shumë. Po kjo ishte thjesht një demonstratë paqësore.

Një karabinier u mundua të qëllonte me kon-

dakun e pushkës një të ri. Bardhyli e njohu. Ishte Xhovani. U drodh, Kondaku për një çast do të godiste në kokën e atij. Po Xhovani u mënjanua. Karabinieri turfulloi si kalë e u mat sërishmi ta godasë, po Xhovani me një lëvizje të shpejtë i mbajti krahun dhe e qëlloi me grusht. Karabinieri u shemb përdhe. Të gjitha këto ndodhën brenda disa sekondave.

Xhovani nisi të vrapojë. Karabinieri i rrëzuar u ngrit dhe uli shulin e pushkës. Bardhyli mendoi se do të shtinte në ajër, sa për ta trembur, por ai shënoi drejt Xhovanit që po i humbiste nga sytë.

Bardhyli deshi të bërtasë, po britma i mbeti në grykë. U dëgjua një krismë dhe Xhovani u rrokullis përtokë.

— Hë, i poshtri! — uluriu karabinieri dhe u sul drejt tij.

Bardhyli e ndoqi pas. Xhovani dergjej i mbuluar në gjak. Një burrë me moshë të thyer u përkul mbi trupin e tij dhe i ktheu fytyrën që nuk jepte shenjë jete.

— Ç'bëre kështu! — thirri burri me moshë të thyer duke iu drejtuar karabinierit, që po afrohej.

— Ç'bëra, hë, atë që duhej të bëja! — u përgjegj karabinieri.

— Po ti vrave vëllanë tënd. Ti u bëre kriminel.

— Hiqmu sysh ti, plak!

Po plakun, duke u dridhur nga urrejtja, përsëriti:

— Vrasës!..

Karabinieri ngriti kondakun e pushkës dhe e goditi plakun në kokë. Goditja qe kaq e befasi-

shme, sa ai nuk pati kohë të lëvizë e, duke rënë, ra së prapthi.

Bardhyli u shastis dhe, pa ditur as vetë, sesi u afrua:

— Përse... e bëre... — i tha duke zvarritur fjalët. — Ai... nuk, nuk bëri asgjë... Përse?..

— Mos do të të godas edhe ty?

Karabinieri, duke sokëllitur do të kish goditur dhe Bardhylin, po në atë çast dikush i mbajti kra-hun. Bardhyli pa oficerin e gjatë italian, me të cilin ishte përplasur pak më parë.

— Mos e nga këtë — tha ai. — Ky nuk është nga ata të demonstratës. E pashë me sytë e mi kur po largohej.

Të dy u bashkuan me oficerë e karabinierë të tjerë; tani po ndiqnin egërsisht turmat, që zbraznin rrugët e qytetit.

Bardhyli kishte mbetur i mpirë. Ai vështronte kufomën e ngrirë të Xhovanit dhe plakun, që vazhonte të rënkonte, duke mbuluar me duart thasëtime kokën e gjakosur.

* * *

Xhovani nuk ishte më. Ishte vvarë. Po përse, ç'kishte bërë? Mund të vritej një armik, një vrasës, një komplotist, po jo një njeri që kishte marrë pjesë në një demonstratë paqësore. Po demonstratat genë të ndaluara nga qeveria fashiste. Vërtet kështu ishte. Atëhere ai duhej burgosur, por jo vvarë.

Dhe atë vetë mund ta kishin vvarë ose plagosur rëndë, ashtu si plagosën atë burrin me moshë të thyer. Dhe përse, përse?

Bardhyli, i shtrirë në shtratin e tij, bluante në kokë të gjitha ato që kishte parë një ditë më parë. Demonstrata që shpërndarë në mënyrë mizore. Shumë qenë plagosur nga goditjet e kondakëve, kamxhikëve, nga plumbat. Tre kishin mbetur të vrarë. Midis tyre dhe Xhovani.

* * *

Në korridoret e Institutit kishte pllakosur he-shtja. Po studentët nuk mund ta përmbanin veten, ndaj murmuritnin haptas. Ata kishin vendosur t'i bënin një varrim madhështor Xhovanit. Kishin ftuar dhe Bardhylin, të vetmin student shqiptar në Institutin e kulturës fizike, të vetmin, se të tjerët, midis të cilëve dhe Faruku, ishin kthyer në Shqipëri.

Bardhyli rishtas solli ndër mend bisedën që kishte pasur atë pasdite me Farukun:

«Bardhyl, edhe ti duhet të kthehesh në atdhe.»

«Nuk mundem, Faruk. Do të humbas të ardhmen time. Ti e kupton. Unë jam dhe futbollist i mirë. Atje do të humbas.»

«Mos e kërko të ardhmen dhe lumtërinë vetëm në botën tënde, Bardhyl. Fashizmi po na vret. Ndaj duhet luftuar.»

Bardhyli u zgjua nga ky lumë mendimesh...

Poshtë nëpër shkallë dhe korridore u dëgjuan trokëllima çizmësh e këpucësh ushtarake. U ngrit rrëmbimthi dhe hapi derën. Pa oficerë dhe karabinierë fashistë, që hynin dhe dilnin nëpër dhomat e studentëve. Po bënin bastisje. Bardhyli deshi të dalë, po një nga karabinierët, që ndodhej në ko-

rridor, e shtyu brenda me forcë. Që nga jashtë dëgjoheshin të shara, britma. E kuptoi që fashistët kërkonin të dinin se cilët nga studentët kishin marrë pjesë në demonstratën e ditës së kaluar.

Kaluan disa minuta ankthi. Pastaj u dëgjuan hapa që afroheshin drejt dhomës së tij. Dera u hap me vrull dhe Bardhyli pa një oficer fashist; pas tij dy karabinierë dhe drejtorin e Institutit. Me ta parë, oficeri fashist u zbut në fytyrë.

— Ah, genke ti — i tha. — Të kam parë kur luan në fushë. S'ke ç'thua, luan bukur vërtet.

— Ky është ylli i skuadrës sonë, — tha drejtori duke vënë buzën në gaz.

Papritur oficeri u mvrejt.

— Besoj se nuk ke marrë pjesë në demonstratë — tha.

— Jo — u përgjigj Bardhyli.

— E merrja me mend. Ti nuk je si ata shqiptarët e tjerë, që trubullojnë ujërat. Dhe mirë bën. Përse të ngatërrohesh kot, kur ke një të ardhme të sigurt? Ti do të bëhesh një futbollist i madh e s'duhet t'i biesh së mirës me shkelm.

— Po, po, Bardhyli e ka vetë të qartë. Ne kemi besim tek ai — tha drejtori.

Pas pak ata u larguan e, ndërsa po zbrisnin nëpër shkallë, Bardhyli pa disa karabinierë, që u kishin vënë prangat tre studentëve, që kishin marrë pjesë në demonstratë.

Ata i arrestuan, ndërsa atë s'e prekën, sepse ishte futbollist i mirë, sepse nuk ishte përzier me demonstruesit, bile dhe e përgëzuan.

Po të kishte ndodhur e kundërta? Atëhere me siguri do të pësonte fatin e atyre.

«Ata janë mashtrues, Bardhyl, janë armiq të tanë, ndaj dhe duhen luftuar», iu duk sikur dëgjonte nga larg zërin e Farukut.

Mbylli derën dhe, i dërmuar, u lëshua në shtrat.

* * *

Kaluan disa ditë.

Xhovanin e varrosën thjesht. Fashistët morën të gjitha masat që të shmangnin çdo të papritur.

Instituti i kulturës fizike, që më parë gumëzhinte, tashti ishte mbështjellë nga një heshtje e rëndë. Korridoret kishin mbetur të nemitura. Studentët dukeshin të zymtë.

Pas dy ditësh skuadra e tyre do të zhvillonte një ndeshje me skuadrën ushtarake të Romës. Po Bardhyli nuk shkoi në stërvitje; ai ndjente një kapitje shpirtërore. Kjo nuk i kishte ndodhur kurrë.

Drejtori e qortoi:

— Duhet të vije, qoftë edhe i sëmure — i tha.

— Sot në fushë ishin dhe disa nga përfaqësuesit e klubit «Virtus». Dëshën të dinin si luan ti.

— Vërtet? — u habit Bardhyli.

— Po mos u shqetëso. Ata përsëri do të vijnë në ndeshje. Çështja është të luash mirë, që t'u biesh në sy. Po të hapen dyert e futbollit të madh. Ke për të parë.

Fytyra e Bardhyilit nuk shprehte asnjë ndjenjë gëzimi.

— Ç'ke, nuk beson? Ja ku po ta them unë. Dhe duhet të ma dish për nder, se po përpiqem posaçërisht për ty, ngaqë më dukesh djalë i mirë. Ti s'je si Faruku dhe ata shqiptarët e tjerë, që u

mashtaruan nga komunistët dhe u kthyen në atdhe.

Duke thënë këto fjalë, drejtori i rrahu butësisht shpatullat dhe u largua.

«Unë jam djalë i mirë, jam i ndershëm, sepse rri mënjanë. Po Xhovani që vdiq, po Faruku që u kthye?»

«Ata janë vrasës, Bardhyl! Ti duhet ta kuptosh», i tingëlloi sërishmi zëri i Farukut.

* * *

Të nesërmen, pas leksioneve, sapo u kthye në konvikt, portieri i dorëzoi një letër. Shkruante i ati. Pas gjithë atyre ditëve të zymta, kjo letër, e ardhur nga Shqipëria, ishte i vetmi ngushullim i tij, ndaj, me ta marrë, Bardhyli nxitoi në dhomë. Do të mësonte si ishte babai, vëllai i tij, të afërmit, të reja të tjera nga Shqipëria. Shumë gjëra do të mësonte.

Kyçi derën përbrenda dhe u shtri në shtrat. Hapi zarfin dhe para syve të tij u shpalosën gërmat e pjerrëta e të mëdha, aq të njohura për të.

Befas u çua rrëmbimthi. Duart i dridheshin, fytyra po i zbehej, sytë i shprehnin tmerr.

«Bardhyli im!

Ti je burrë, pra bëhu gati të mësosh një lajm të kobshëm. Vëllanë tënd e vranë...»

Bardhyli iu morën mendtë. Iu duk se po notonte në një mjegull të dendur.

«E vranë! Po kush e vrau, përse?..»

«... Atë pasdite në qytetin tonë po bëhej një demonstratë e madhe. Rrugët qenë mbushur plot njerëz, të mëdhej e të vegjël.»

Bardhyli mbeti disa çaste. Lot të nxehtë nisën t'i rrëshqasin faqeve.

«Po pse bëhej kjo demonstratë?»

Në letër nuk arriti ta gjente këtë përgjegje. Siç duket, babai ishte drujtur të shkruante më gjatë, nga që letra mund të hapej, siç ndodhte jo rrallë.

«Po vëllai ç'bëri që e vranë?»

«Ai u bashkua me të tjerët dhe eci në ballë. Pastaj u dëgjuan të shtëna dhe ra i përgjakur...» vazhdonte letra.

«Pra, paska ndodhur ashtu si në demonstratën e disa ditëve më parë. Duhet të ketë qenë një demonstratë e madhe. Përse janë ngritur? Sigurisht kundër fashistëve. Ndryshe ata nuk do të shtrëngoheshin të qëllonin. Mbase dhe janë përleshur me ta, ashtu të paarmatosur».

Bardhyli solli ndër mend turmat e njerëzve, që biusnin nëpër rrugë karabinierët me fytyra të sterrosura. Kështu duhej të kish qenë dhe në demonstratën për të cilën i shkruante i ati.

Pastaj, si një vegim, iu shfaq skena e llahtarshme: Xhovani duke rendur, karabinieri gjakësor, duke e ndjekur pas, krisma e pushkës... Xhovani i përgjakur, plaku duke mbajtur trupin e tij pa jetë... Pastaj kondaku i pushkës, në duart e karabinierit që u përplas me forcë në kokën e plakut.

Përfytyroi vëllanë dhe turmat e banorëve të qytetit të tij, dhe iu duk se i kish jetuar ato çaste.

«Im vëlla qëndroi në ballë të tyre. Me siguri dhe do të jetë kacafytur me fashistët, me siguri dhe i ka goditur. Dhe ata kanë shtënë kundër tij, kundër të gjithëve, sepse kanë ndjerë se e tërë kjo

mizëri njerëzish i urren për vdekje... Kurse unë... unë... ç'bëra unë?... Të kundërtën! bërtiti i tmerruar dhe shtangu.

«Sikur im vëlla ta dinte këtë, sikur ta dinte dhe babai që më shkruan këtë letër, do të më quanin frikacak!

Bardhyli nuk mundi të përmbante një gulçim, që i doli thellë gjoksit.

Tani e kishte të qartë: Nuk ishin vetëm komunistët që luftonin kundër fashistëve, po i tërë populli, ndryshe nuk do të ngrihej në demonstratë. Po këtë ai nuk e dinte dhe as që mund ta dinte, sepse fashistët nëpër gazeta dhe revista thoshin se kudo në Shqipëri priteshin me lule. Po e vërteta ishte krejt ndryshe. Ajo nuk mund të fshihej më para syve të tij.

«Bir!..

Duroje këtë dhimbje, siç po e durojmë dhe ne prindërit që kemi mbetur vetëm. Tani gjyko si të duash, po ne do të donim që ti të ktheheshe».

Bardhyli iu duk se i ati kish lënë përgjysmë një frazë: «... të ktheheshe, që t'i zije vendin atij...»

«Bardhyl! Ti tani e ke të vështirë të kuptosh të vërtetën. Po s'do të jetë e largët dita që ajo do të shfaqet e qartë e ti do të kthehesh, patjetër do të kthehesh,» iu shfaq zëri i Farukut.

Ai u ngrit dhe për disa çaste mbeti pa lëvizur.

Iu kujtua oficeri fashist, që e kish mburrur se luante mirë, drejtori me buzëqeshjen e shtirë, që krekosej se Bardhyli ishte nga ata shqiptarë, që nuk trubullonte ujërat.

Ja pra ç'na paskëshin qenë të gjitha këto fër-

kime, përkëdhelje, mashtrime gjoja për të ardhmen e tij, për të ardhmen e shkëlqyer. Dhe ai u kish besuar këtyre profkave, kishte menduar vetëm për veten e tij, kishte mbetur i mënjanuar.

«Paskam qenë vetëm një egoist i vogël, oh sa i vogël!» murruriti dhe shtrëngoi grushtet, si të donte të përmbante mërinë, që e kish pushtuar.

C'të bënte?

Të shkonte e t'ja përplaste të gjitha drejtorit të pështirë? Mjaft më!

Ndjeu ta pushtojë një urrejtje e thellë; rrëmbeu statujëzën e bronxtë të një atleti të lashtë, që ndodhej mbi tryezë dhe u mat të sulej drejt në zyrën e drejtorit.

Rrëmbimthi hapi derën e dhomës, po për një çast nguroi; pastaj mbylli derën dhe bëri disa hapa, si i trallisur.

«E ç'vlerë do të kishte kjo?» — tha me vete. «Ai s'është veçse një kufomë e gjallë. Duhet bërë tjetër gjë: duhen goditur fashistët atje në Shqipëri. Plumbit i duhet përgjegjur me plumb. Babai ka të drejtë. Sa më parë në atdhe». Hodhi tej statujëzën që mbante në dorë dhe doli me vrull nga dhoma. Duke zbritur shkallët e mermerta, ndjente një forcë të padukshme që e rrëmbente dhe e shpinte përpara.

URREJTJE

— Ju nuk mund ta merrni dot me mend, herr kapiten. Ai m'u vërsul si bishë e plagosur e më mbërtheu për fyti. O nëna ime, çfarë shtrëngimi! M'u duk se do të mbaroja, bile gati mbarova...

Toger Hërsti, një prusian tipik me flokë të verdhë e sy të përhimë, ecte pas kapitenit Jurgens e vazhdonte t'i shpjegonte, ndërsa tjetri gajasej së qeshuri, kur shihte qafën e shtrembëruar të var-tësit të tij.

— Po lavdi zotit që u ndodhën aty pranë dy nga ushtarët tanë. Ata e qëlluan me kondakët e pushkëve dhe atëhere shpëtova — vazhdoi toger Hërsti.

— Pse nuk thoni atëhere që e paskeni lënë të vdekur — tha kapiten Jurgensi.

— O, mos u shqetësoni! Ai sikur ka shtatë shpirtra e s'vdes kurrë. E kemi rrahur, torturuar, po mbahet. Vetëm se tani i ka rënë të fikët. Ja, keni për ta parë.

Të dy kaluan nëpër një korridor të errët e u ndalën përpara një qelie. Toger Hërsti hapi derën dhe ata u ndodhën brenda në qeli.

— Ja tek është — tha toger Hërsti.

Kapiten Jurgensi rrotulloi sytë nëpër qeli dhe në qoshen gjysmë të errët pikasi një djalosh jo më shumë se njëzet vjeç, të mbështetur rrëzë murit me duar të lidhura.

— E paskeni lidhur? — pyeti si me çudi kapiten Jurgensi.

— Bile fort mirë, — u përgjegj toger Hërsti.

— Ju paska kallur datën!

— Ashtu vërtet. Edhe kështu është për ta pasur frikë. Ai ka një forcë të tmerrshme, edhe zinxhirët mund t'i këpusë.

— Po e teproni tani.

— Aspak, për besë. Shikojini krahët.

Vërtet, duke u afruar, kapiten Jurgensi dalloi qartë trupin e bëshëm të djaloshit, krahët e fuqishëm muskulozë, që shquheshin përmes këmishës së shqyer.

— Paskeni të drejtë — tha pastaj. — Po ç'punë bënte ky?

— Farkëtar.

— Aha, është e qartë. Ndaj ka dhe ky trup kaq të zhvilluar.

— Thonë që është marrë dhe me mundje.

— Ashtu? — u çudit kapiten Jurgensi.

— Bile është kampioni i këtij qyteti.

— Habitem; po ku e njohin mundjen në këtë qytet të vogël, ku dhe sportet e tjera nuk janë përhapur?

— Kështu mendoja dhe unë, po në Shqipëri zhvillokan një lloj mundjeje të veçantë, një lodër të vjetër popullore — shpjegoi toger Hërsti.

Kapiten Jurgensi bëri disa hapa nëpër dhomë e pastaj u kthye nga togeri me pamje të qeshur.

— E dini se më lindi një ide e goditur? Bile fort e bukur — tha pastaj.

— Nuk po kuptoj — u përgjegj toger Hërsti.

— Dua të ndeshem me të në mundje.

— Si? Të ndesheni me të!

— Mos u habitni. Në akademi kam qenë kampion në mundjen e lirë, po kështu edhe më pas në korparmatën e këmbësorisë. Sot, po të mos ndodhesha këtu, mund të isha kampion i Gjermanisë.

— Po ai... ai është i tmerrshëm!..

Kapiten Jurgensi qeshi.

— Ju i stërmadhoni gjërat, toger. Mendoni se edhe unë nuk jam i pakët.

Pas këtyre fjalëve, kapiten Jurgensi xhveshi xhakëtën duke zbuluar gjoksin e tij muskuloz, që fshihej pas një fanelle të hollë pambuku. Pastaj mori një kovë me ujë të ftohtë, që ndodhej pranë derës së hekurt dhe me forcë e derdhi në fytyrën e djaloshit.

Ai u drodh, rënkoi lëvizje qepallat e, duke hapur sytë, i hodhi një vështrim të egër kapiten Jurgensit. Pastaj, duke pandehur se ai po përgatitej ta godiste, tendosi krahët, që shkundën zinxhirët e e lidhur fort pas duarve dhe u bë gati të priste sulmin.

— E shikoni — tha toger Hërsti, — sa i tmerrshëm është? Ç'urretje shprehin sytë e tij! S'kam parë kurrë sy të tillë. Ai na urren për vdekje.

— Ç'pandehni ju, mos duhet të na dashurojë? Ne e kapëm kur po përgatitej të ikte partizan, në sytë e tij i rrahëm nënën, vetë atë e rrahëm dhe e torturuan. Vallë pak i kemi bërë?

Djaloshi tani qe ngritur në këmbë.

— Ke qëndruar si burrat — i tha kapiten Jurgensi. — Qenke trim i hazdisur. Dhe ne i nderojmë trimat. Po ti për ne je armik dhe ne i luftojmë armiqtë. Veç të tjerash, për pak mbyte dhe zotin Hërst, toger i ushtrisë së Hitlerit. E kupton ç'pëson nga kjo?

Djaloshi vazhdonte të vështronte gjithnjë ngultas.

— Pushkatohesh, ja ç'pëson, — vazhdoi kapiten Jurgensi — aq më tepër që ti nuk do të tregosh lidhjet me partizanët. Po mos kujto se gjermanët janë kaq të egër... Ata dinë të sillen mirë. Ja për shembull, unë do të të fal jetën.

Djaloshi ngrysi vetullat.

— Po, po, mos. u habit. Unë do të të fal jetën. Por me një kusht.

Sytë e djaloshit po e vështronin tani me urrejtje e përçmim.

— Ti je më i forti i qytetit në mundje. Kështu?

Djaloshi pohoi me kokë.

— Sigurisht do të të pëlqente përsëri të bëje mundje. Trupi yt i fortë atëhere do të përtërihej. Unë po ta jap këtë mundësi. Nesër, sigurisht pasi të çlodhesh e të marrësh veten, (kapiten Jurgensi i hodhi një vështrim si me keqardhje trupit të cfilitur të djaloshit) do të dalësh sërish të bësh mundje.

Djaloshi e vështroi me çudi.

— Kundërshtari yt do të jem unë. Çuditësh apo jo? Aq sa u çudita dhe unë kur mora vesh se ke qenë mundës. Po dhe unë kam qenë mundës, bile kampion si dhe ti; dhe mua më ka marrë malli të ndeshem, të fitoj. Ma merr mendja që do të

jemi kundërshtarë të denjë për njëri-tjetrin. Pastaj kemi pothuajse një trup.

Djaloshi po e vështronte me përbuzje.

— Harrova të them kushtin. Po të fitosh, atëhere... atëhere do të jesh i lirë. Po të humbasësh, e kuptueshme, do të vdesësh. Siç e sheh, kushti është i leverdisshëm. Mund të dalësh i fituar.

Sytë e djaloshtit këtë radhë shkrepëtinë dhe ai u përtyp.

— Vetëm mos harro se unë nuk jam si toger Hërsti. Do të bindesh.

Kapiten Jurgensi rrëmbeu një shufër të hekurt me të cilën torturoheshin të burgosurit dhe e shtrëngoi fort nga të dyja anët. Shufra filloi të dridhej nga shtrëngimi i fortë, pastaj të epej, derisa, pas përpjekjesh të mëdha të kapitenit Jurgens, që ishte skuqur i tëri në fytyrë, nisi të përkulet.

— E pe? Pra, nuk do ta kesh të lehtë, djalosh! Kështu, pra, nesër në mëngjez.

Kapiteni, duke marrë frymë thellë, veshi xhaketën e doli jashtë i ndjekur nga toger Hërsti.

— Herr kapiten, vërtet kini ndër mend të ndesheni me të? — tha me zë të zvargur toger Hërsti.

— Pandehni se bëj shaka? Dua ta provoj dhe unë shtrëngimin e krahut të tij që të ka llahtarisur kaq shumë.

— Dhe po t'ju mundë, dua të them... po arriti t'ju mbështesë me shpatulla në tapet, vërtet do ta lini të lirë?

Kapiten Jurgensi shpërtheu në një të qeshur sarkastike.

— Sa naiv që jeni. Së pari, ai nuk do të më

mundë. Sado i fortë të jetë nuk mund të mposhtë një oficer nazist, duke ju përjashtuar ju. (Fjalët e fundit, i tha me ton serioz, i mvrejtur). Së dyti, edhe sikur të ndodhte kjo, do ta vrisja në vend. Ai është i humbur në të gjitha variantet; asgjë nuk e shpëton.

Kapiten Jurgensi qëndroi e, duke shtrënguar duart e mëdha, vazhdoi:

— Dua t'u jap një mësim të mirë dhe të gjithë këtyre të burgosurve komunistë, që mbushin qelitë. Ta marrin vesh ata se ne i gjunjëzojmë jo vetëm me forcën e armëve tona, po edhe me forcën e krahëve. Bile do të mundohem ta mbys në vend, me duart e mia, sa ata të tmerrohen.

Kapiten Jurgensi ckërmiti dhëmbët e shpërtheu përsëri në gaz.

— Pra nesër, toger, nxirrni gjithë të burgosurit në sheshin e burgut. Porositini të jenë aty gjithë oficerët dhe ushtarët tanë.

Duke thënë këto fjalë, u largua, ndërsa toger Hërsti mbeti me gojë hapur, si një njeri që diç kërkon të shpjegojë, po që lëkundet në mëdyshje.

* * *

Për herë të parë, pas dy ditësh e dy netësh, djaloshi e ndjeu veten të çliruar nga shtrëngimi i zinxhirëve, që i copëtonin mishrat e duarve. Përballë tij ai pa kapiten Jurgensin gjysmë të zhveshur. Trupi i tij herkulian shkëlqente.

«Qenka lyer me vaj» tha me vete.

«Kështu është më mirë. Sado të mundohet, duart e tij do të rrëshqasin», mendoi kapiten

Jurgensi duke kundruar trupin e zeshkët të djaloshit, ku dukeshin ende gjurmët e gjakut e të rrahjeve.

Ai hodhi sytë përreth e, duke parë radhët e nemitura të të burgosurve dhe pranë tyre kolegët e tij, kujtoi sallat sportive dhe palestrat, ku kish fituar gjithë ato ndeshje dhe ndjeu ta pushtojë një ndjenjë krenarie.

(Djaloshi solli ndër mend turmat e bashkëmoshatarët e tij, që grumbulloheshin në sheshin e mëhallës dhe i jepnin zemër. Edhe sytë e të burgosurve shprehnin po atë ndjenjë.

«Ata presin nga unë, presin që ta mund».

Të dy qëndruan tre metra larg njëri-tjetrit, pastaj u përkulën, ngritën krahët, shtrënguan nofullat.

Dy metra...

Ata rrotulloheshin nëpër tapet, duke u orvatur të gjenin ndonjë gjymtyrë të zbuluar.

Një metër...

Ndjenë frymëmarrjen e njëri-tjetrit. U sulën dhe u kapërthyen.

«Le ta dijë sa i fortë është oficeri gjerman».

«Ah, në e mbërthefsha mirë! Do ta shohë vetë ç'forcë ka shqiptari».

Ata po rrotulloheshin të mbërthyer gjoks për gjoks, krah për krah, duke gulçuar.

«Ç'më rrëshqasin duart. Duhet zënë, duhet mbërthyer, mbërthyer sa më fort...»

Në ato çaste djaloshit iu shfaq vëllai i vrarë e i masakruar nga gjermanët pas aksionit në komandaturën gjermane, të organizuar nga shokët e

njësitit guerril. Pastaj iu kujtua betimi i tij për t'i zënë vendin në radhët partizane, bastisja...

Ai futi duart nën shpatullat e forta të gjermanit dhe u përpoq t'i kryqëzojë për ta rrëzuar kështu në tapet.

«Qenka vërtet i fortë ky djalë. Çudi si nuk e kanë dërmuar të rrahurat, torturat!» mendoj kapiten Jurgensi.

... Djaloshi s'kishte arritur të ikte. Dhjetëra gjermanë i ishin futur në shtëpi. Të kishte vrarë të paktën disa prej tyre. Po s'kish pasur me se veç duarve të tij të çelikta. Nëna kish dashur t'i ndalë. E kishin rrahur. Dhe ai ish përleshur, i kish dërmuar. Të kishte mbytur të paktën atë oficerin me flokë të verdhë. Dhe do ta kishte mbytur. Por...

Të dy u rrokullisën në tapet. Duart e tij rrëshqitën dhe u shkëputën nga kurrizi i lëmuar i gjermanit. Ndjeu pastaj një shtrëngim të thellë mbi shpatulla, rrëzë qafës.

Gjermanët e tjerë qeshën me zë të lartë.

Të burgosurit heshtën.

«Po ata presin që unë ta mund.»

«Edhe pak e do të shohësh ç'është forca e oficerit nazist. Do të të mbyt, këtu» tha me vete gjermani.

Të dy u vështruan sy në sy. U vështruan me urrejtje.

Djaloshit iu duk se kapiteni që i veshur me uniformën e tij të gjelbër. Dyshekët e gjelbërt, që shërbenin si tapet në sytë e tij u shdërruan në një lëndinë të gjelbër. E aty, pas një kaçubeje, kur ai po bëhej gati të bashkohej me partizanët, iu duk sikur i doli përpara kapiteni që iu hodh sipër, sikur po

e mposhte, për ta hedhur në greminë anës së lëndinës sikur disa gjermanë me helmata të murme në kokë po talleshin me të tek sa kapiteni po e zvarriste drejt greminës.

... Djaloshi u përmend. Gjermanët përreth po gajaseshin, togeri, të cilin për pak do ta kish mbytur, po e tregonte me gisht, e po shkrihej në histeri. Të burgosurit qenë gozhduar në ankth.

«Mbahu, djalosh, qëndro, mos u jep!» dëgjoi një zë që çau përmes britmave të çjerra të gjermanëve.

«Mos u jep!» iu bë se i foli zëri i vëllait të përgjakur që po jepte shpirt.

«Mos u jep, bir!» përsëriste nëna duke mbajtur lotët.

Gjermani përkulej mbi të.

«Edhe pak edhe s'e ka të gjatë ky çunak».

«Sikur ta mbërtheja për zverku? Duhet durim.»

... Djaloshit përsëri si nëpër ëndër iu faneps lëndina e gjelbër, partizanët diku në shtigjet e gjelbëra, kapiteni gjerman edhe ai me uniformë të gjelbër, dhe gjithshka përreth iu shkri në ngjyrë të gjelbër. Oficeri gjerman orvatej ta rrokulliste drejt greminës. Gjermanët e tjerë vazhdonin të gajaseshin. Atë e priste vdekja...

Bëri një lëvizje të vrullshme dhe iu shkëput duarve të kapiten Jurgensit. Kjo ndodhi kaq shpejt, sa ai për një çast e humbi drejtpeshimin dhe mbeti i përkulur përpara me duart mbi tapet. Djaloshi këtë radhë e përfshiu me krahët e tendosur në qafë.

Për disa çaste sheshin e mbërtheu heshtja. Gjermanët u stepën. Të burgosurit morën frymë e

zgjatën përpara duart e lidhura. Kapiten Jurgensi u shkund, u drodh, tendosi qafën duke u rrudhur në fytyrë, po nuk lëshoi asnjë britmë.

«Hë tani, lëviz po të duash, qen...» mendonte djali.

«Pandeh se më mposhte? Prit do ta shohësh!» thoshte me vete kapiteni.

Po djaloshi po shtrëngonte duart në qafën e qullur në vaj e djersë të kapitenit Jurgens.

Toger Hërstit i shpëtoi një klithmë. Ai solli ndër mend shtrëngimin e tmerrshëm të djaloshit.

— Ej, ai do ta shtrëngojë dhe më fort, do ta...

Po fjala i mbeti në grykë. Njëri nga oficerët e tjerë gjermanë e shikoi vëngër.

— Mos llototit më ti, frikacak. Kapiten Jurgensi nuk është si ti — i tha. — Ai do ta mposhtë, ke për të parë.

Deshi të lëvizë, t'i afrohej kapitenit e ta ndihmojë, por mbeti, kur pa gjermanët e tjerë të ngurosur.

«O perëndi, ç'është kështu!» mendoi kapiteni Jurgensi të cilit po i errësohej gjithshka përreth.

«Për vëllanë e vrrarë, qen, për nënën, për partizanët, për këta të burgosur, që i ke torturuar mizorisht».

Kapiteni u përpoq të çlirohej, ta kafshonte, të ulurinte, po nga gryka e përtharë nuk i doli asnjë tingull. Po i merrej fryma, po i erreshin sytë.

Iu kujtua palestra, kundërshtarët që kish mundur, po këtu po mundej, këtu po...

Djaloshi e shtrëngoi dhe më shumë. Kapiten Jurgensi lëshoi vetëm një britmë të mbytur dhe mbylli sytë si të mposhte dhëmbjen.

... Djaloshit iu shfaqën lëndinat, kaçubeja,

oficeri gjerman, që po dergjej në agoninë e vdekjes, partizanët që po brohorisin. . .

E përmendën brohoritjet e të burgosurve.

Kapiten Jurgensi qe shtrirë me shpatulla në tapet; ai orvatej të ngrihej, po duart muskuloze të djaloshit po i shtërngoheshin në fyt. Befas, përmes buzëve të nxira, i shpërtheu një rënkim.

— Ai po e mbyl! — klithi i lebetitur toger Hërsti.

Oficerët gjermanë u vërsulën dhe e shkëputën kapiten Jurgensin nga duart e djaloshit. Por djaloshi u ngrit më këmbë dhe iu vërsul sërishmi kapiten Jurgensit që, tek e pa, ashtu i dërmuar siç ish, duke sjellë ndër mend tmerrin që kish parë me sy, u zbyth i llahtarisur.

Djaloshin e shtynë, e goditën me kondakët e pushkëve. Po ai rishtaz u ngrit më këmbë.

— Qëlloni nazistë të ndyrë, po mjerë ju! Kështu do ta pësoni të gjithë! — briti ai duke u vërsulur ballëhapur mbi ta.

Toger Hërsti, që pa se si grushtet e mëdha të djaloshit po binin mbi kokën e kapitenit, nxori revolverin vetëtimthi dhe e qëlloi disa herë radhazi në gjoks. Djaloshi u lëkund, po grushtet nuk i uli dhe, duke u hedhur një vështrim të tmer-shëm nazistëve, u rrëzua për tokë.

Kur panë djaloshin trim të përgjakur, të burgosurit, me duar të lidhura siç ishin, u hodhën mbi nazistët, duke u munduar të qëllonin si të mundnin. Zërat e tyre ngriheshin në kor, kapërcenin tej mureve të larta të sheshit të burgut e përplaseshin në atë copë të kaltër qielli, që ngrihej sipër si kupolë e kristaltë, e brishtë e brishtë.

DYLUFTIMI I HESHTUR

Kolegut tim A.M.

Për herë të parë pas kaq vjetësh ai e ndjeu veten të shqetësuar. U fut në kabinën e transmetimit dhe sakaq, përpara tij, sipas siparit të një skene gjigande, u shpalos pamja e stadiumit me shkallët e gurta, si shkallët e amfiteatrove antike; u dukën spektatorët që dallgëzonin, fusha që i shembëlente një qilimi të gjelbër dhe futbollistët që endeshin në të.

Ato çaste ai pa qindra sy t'i drejtoheshin të ftohtë, të akullt, plot përcmim e përbuzje dhe i shembëlleu vetja si një aktor që për herë të parë del në skenë i ndjekur nga sytë e spektatorëve indiferentë.

Kurrë nuk e kishte ndjerë këtë shqetësim. As edhe atë ditë kur kishte transmetuar ndeshjen e parë, menjëherë pas çlirimit. Kurse tani, pas katër vjetësh, pas kaq e kaq transmetimesh po e përshkonte një ndjenjë ndrojtjeje.

Sytë e të huajve nuk i ndaheshin. «Këta janë gazetarët dhe udhëheqësit sportivë të skuadrës tjetër», tha me vete. Ata kishin filluar të silleshin ndryshe. Kujtoi buzëqeshjet e shtira frazat e shkëputura që fshihnin një ironi të hollë, komentet e gazetave plot optimizëm, ku thuhej haptazi se skuadra

shqiptare do ta humbte, patjetër do ta humbte atë ndeshje. Tani ata përsëri, po buzëqeshnin me shpoti, sikur të donin t'i thoshin: «Çfarë do t'u japësh ti atyre në Shqipëri, mandatën? Çfarë tjetër do t'u japësh!»

Në kabinën pranë u dëgjua zhurmë. Ai ktheu kokën dhe nëpërmjet paretit prej xhami, që mbulonte pjesën e përparme të kabinës, pa të ulej radiokronistin e huaj, që zgjat kokën drejt tij. Pa po atë buzëqeshje, po atë shikim dhe iu duk sikur po i thoshte me një keqardhje të shtirur plot ironi: «Pisk do ta kesh kur të transmetosh mandatën, por s'të ndihmon dot njeri».

U shkund si të ish zgjuar nganjë ëndërr e frikshme dhe iu duk se bashkë me të u shkund dhe shqetësimi, që kish filluar ta mbëshjellë si një mjegull e dendur. S'pat kohë të mendojë më gjatë, sepse pa futbollistët të dilnin në fushë. Dëgjoi duartrokitjet që u lëshuan me ngathtësi nga shkallët e stadiumit, britmat, që ngriheshin diku andej-këtej si të copëtuara e të zvarrisura e nuk po kuptonte përse shkallët qenë të zymta, sikur në fushë të luhej finalja e një tragjodie shekspiriane; pastaj pa futbollistët shqiptarë që qenë shpërndarë në fushë. Disa prej tyre që nga larg i ngulën sytë drejt tij me një vështrim të çiltër, sikur t'i thoshin: «Ti mos u shqetëso! Ne do të luftojmë; ke për të parë!»

Ai vuri buzën në gaz. Desh t'u bëjë shenjë me dorë, po atë kohë ndjeu zërin e radiokronistit të huaj, që vinte si jehonë e largët. Vështrimet e tyre u kryqëzuan. Vuri re, përmes atij paretit të hollë prej xhami, sytë e radiokronistit që, duke

fclur, i hidhte ndonjë vështrim plot përçmim. Pas pak do të fillonte të fliste dhe ai. Vetëm pas pak. Përsëri ndjeu të mbështillej nga mjegulla e shqetësimit. Solli ndër mend se tani Radio-Tirana po trasmetonte emisionin e lajmeve të mesditës. Folësit me siguri po jepnin njoftime nga Shqipëria: ndoshta njoftonin për kilometrat që po i shtoheshin hekurudhës Durrës-Elbasan, mbi tokat e reja që po i rrëmbeheshin kënetës së Tërbufit. Sa e sa njoftime të reja mund të jepnin ata tani. Dhe me siguri dëgjonjësit, të mbërthyer pranë radiove, tundnin kokat, buzëqeshnin, mbase dhe përplasnin duart, pa e përmbajtur veten; mbase dhe thoshin: «Ju lumtë, këto janë fitore!...»

Kurse pas pak ata do të dëgjonin zërin e tij që do të vinte nga qindra e qindra kilometra larg, nga një tokë e huaj.

Vështrimi i tij rrëshqiti mbi tribunat e spektatorëve. Pa po ato fytyra, me po ato shprehje, pastaj ftohtësinë dhe indiferencën, që varej mbi turmat e dallgëzuara, futbollistët që po bëheshin gati të fillonin ndeshjen dhe vështrimi i syve të tij përsëri u ndesh me atë të radiokronistit të huaj. Ai tani po fliste për skuadrën shqiptare. Përmendte se ajo kryesonte në atë turne ndërkombëtar, po në ndeshjen e asaj dite patjetër do të humbiste vendin e parë. Radiokronisti i huaj, fliste me një ton të qetë, të sigurt, thuase gjithshka ishte zgjidhur, pa filluar ende ndeshja.

Ai ndjeu ta përshkonte një valë e nxehtë; shtrëngoi mbajtësen e hekurit të mikrofonit dhe, pasi i dhanë shenjën, nisi të flasë. Shqiptoi po ato fjalë, që kish shqiptuar sa e sa herë: «Të dashur dëgjonjës

nga Shqipëria! Fillojmë trasmetimin e ndeshjes...»

E dinte se zëri i tij fluturonte tej kaltërsive, nëpërmjet telave të hollë, që zgjateshin pa mbarim e buçiste në altoparlantet e radiove atje në atdhe. Atë e dëgjonin tani edhe vullnetarët e hekurudhës, të ulur diku pranë një altoparlanti, edhe punëtorët e ndonjë kantieri ndërtimi. Mbase e dëgjonin edhe fshatarët e ndonjë kooperative të re, që kishin ngritur centralin e tyre elektrik, mbase dhe kufitarët në orët e lira, mbase marinarët në det. Tërë Shqipëria atë po dëgjonte. Solli ndër mend turmat e njerëzve që i kishin përcjellë në aeroport, fjalët e tyre «Sukses, na nderoni!» dhe ndjeu përsëri t'i rrahë zemra, si kurrë ndonjëherë.

Edhe ai tani po fliste, ndërsa zëri i radiokronistit të huaj po humbiste në sfondin e zërit të tij, si një re e vetëmuar, që tretet në pafundësinë e qiellit.

Loja kishte filluar. Skuadra tjetër sulmonte; bile sulmonte dendur. Ishte e qartë, ajo donte të siguronte epërsi qysh në minutat e para. Atëhere nga shkallët u ngrit një pasthirrmë zërash të shkëputura, u shtri, u zgjat, po përsëri u mblodh si gjymtyrët e një shumëkëmbëshi. Spektatorët dukeshin sikur lëkundeshin në dallgët e pasigurisë dhe të mëdyshjes. Po zëri i radiokronistit të huaj gjëmoi fort, aq sa ai dëgjoji qartë disa nga fjalët e thëna shpejt: ... «...Po, po, edhe për pak ne do të shënojmë. Shqiptarët mezi mbrohen.» Vuri re që në ato çaste radiokronisti i huaj kishte kthyer vështrimin nga ai. Nga ai qenë kthyer edhe vështrimet e gazetarëve në shkallët e stadiumit; në to shqoi po atë përcmim, që nënkuptonte fjalët: «...mandatën, çfarë tjetër do t'u japësh!»

Shtrëngoi sërishmi mbështetsen e ftohtë të mikrofonit dhe vazhdoi të flasë, duke ndjekur të gjitha lëvizjet atje në fushë. «Tanët mbrohen mirë». E përsëriti disa herë këtë frazë që vërshoi përmes fjalëve të thëna shpejt, vullshëm, ashtu siç mund të ndodhë vetëm në trasmetimin e një ndeshjeje futbollit.

«Tanët mbrohen mirë!»

Atij iu duk se tani këto fjalë, duke kaluar përmes xhameve të kabinës, përplaseshin në fytyrën e dërsitur të radiokronistit të huaj e, që andej, shpërthenin mbi kokat e gazetarëve dhe të udhëheqësve sportive të skuadrës kundërshtare, që gajaseshin e përplasnin duart, dhe arrinin deri te futbollistët me ritëm të shumëfishuar. «Tanët mbrohen mirë». Pastaj po me këtë ritëm ktheheshin tek ai. «Po, mirë po mbroheni!»

Në ato çaste përfytyroi dëgjonjësit nga Shqipëria e largët, fytyrat e vullnetarëve, të fshatarëve, që kishin blerë radiot e reja, të kufitarëve në kufi apo të marinarëve në det. Me siguri ata në ato çaste shprehnin emocion, shqetësim, çka kish ndjerë edhe ai para pak minutash. Cfarë mund t'i qetësonte? Vetëm fjala e tij e qartë, e çiltër, me zë të sigurt e jo të dridhshëm, që kishte si refren po atë frazë: «Tanët mbrohen mirë!»

Dhe ja, papritmas, e ngriti zërin, që kumboi si kushtrim. Ata po kundërsulmonin. Atij iu duk se tërë stadiumi u tkurr. Radiokronisti i huaj diç belbëzoi dhe mbeti si i pushtuar nga paniku, gazetarët u shikuan sy në sy e mbi shkallët sikur u lëshua e ashpër dhe ogurzezë një heshtje kërcënuese. Iu duk se mbi stadium atë

çast sundonte vetëm zëri i tij: «Tanët po kundërsulmojnë!»

Por jo, nuk dëgjohej vetëm zëri i tij. Diku në shkallët e stadiumit dëgjoi brohoritje shqip. Ato ngriheshin valë-valë duke përpirë heshtjen kërcënuese e arrinin deri tek ai të kthjellëta, të vrullshme. «Këta janë shqiptarë. Nuk jam i vetëm këtu në shkallët e stadiumit» mendoi.

Për disa çaste heshti. Brohoritjet shqip bucisnin këmbëngulëse e të kumbueshme. Ai e dinte se në ato sekonda, duke gjetur shteg përmes mikrofonit, që ndriçonte me një shkëlqim të venitur, brohoritjet sulleshin për të fluturuar, atje në Shqipëri. Edhe atje në ato shkallë të huaja në atë ambient të zymtë, që po ndrydhej nën peshën e asaj heshtjeje, ishte një Shqipëri e vogël. Atë e përbënin ai vetë, shqiptarët në shkallë dhe ata në fushë qo po sulmonin.

Ktheu kokën dhe përmes xhamit pa radiokronistiin e huaj. Ai po fshinte djersët që i mbulonin fytyrën e skuqur; vazhdonte të derdhte një lumë fjalësh; mundohej të tregohej i qetë, po zëri i dridhej. Edhe ai e pa, po u mundua t'i shmangej vështrimit të tij, siç po bënin ata gazetarët e udhëbësësit sportivë të skuadrës tjetër, që dukeshin të nemitur, ndërsa brohoritjet rrukulliseshin si buçimë tronditëse në shkallët e mpira të stadiumit.

... Kështu vazhdoi edhe në pjesën e dyte. Fusha i ngjante një deti që shfrynte me tallaze. Dhe tallazet ndiqnin njëri-tjetrin në drejtime të kundërta. Dhe shuheshin me oshëtime të kundërta. Zëri i radiokronistit të huaj herë ngrihej, grindej, shpërthente me nervozizëm, herë shtrihej e humbiste, ashtu siç humbisnin dhe britmat e copëtuara të zva-

rritura, që endeshin vërdallë mbi shkallët e stadiumit. «Ata këtu do të humbasin; do të pësojnë humbje të thellë. Humbje dhe asgjë tjetër. Dhe nga vendi i parë do të bien.» Këto qenë fjalë të harruara e të braktisura. Ai nuk guxonte t'i përsërishte.

Në sfondin e këtij zëri që përtypej në ankth, ngrihej zëri i tij, që tretej në jehonën e brohoritjeve të atyre pak shqiptarëve. Ata brohorin pas çdo sulmi. Skuadra e huaj, që kishte zbritur në fushë e sigurt se do të fitonte, mezi përmbante këtë rrebesh: shtrëngohej, mblidhej, gulçonte dhe priste në agoni të treteshin minutat e fundit.

Ndërsa ai fliste pareshtur. Kurrë nuk i kishte ndodhur të fliste aq shpejt, po dhe të lodhej aq shpejt. Sidoqoftë, tani që ndjente se sytë po i visheshin me një vello të murme, u mundua ta mposhtte këtë lodhje, me ritmin e shfrenuar të fjalëve, që shpërthenin nga buzët e përthara, ndaj përsëriti me zë të fortë: «Tanët po e përballojnë këtë provë të vështirë, kurse kundërshtarët duan të ruajnë barazimin.»

... Dhe e ruajtën pas përpjekjesh të dëshpëruara. Ky ishte një barazim disfate për ata që me aq besim kishin nxirë me gërma të mëdha faqet e gazetave (dhe tani së bashku me udhëheqësit e tjerë sportivë nuk guxonin ta vështronin), për radiokronistin që kishte dërdëllisur para mikrofinit se shqiptarët do të humbisnin e do të pësonin shumë gola. Zëri i radiokronistit tani po zvargej. Pas pushimeve të shkurtëra ai madje as nuk arrinte të dëgjonte qoftë edhe një rrokje. Kjo e habiti ndaj zgjati kokën dhe vështroi ngultas. Ky vështrim

e shkundi radiokronistin e huaj. Por ai nuk arriti t'i shmangej syve të tij. Për të fundit herë vështrimet e tyre u kryqëzuan dhe në tiparet e tij vuri re zemërim e ligësi. Radiokronisti i huaj diç murmuriti dhe u largua duke mbyllur me zhurmë derën e kabinës.

Kurse ai po fliste. Atëhere ndjeu ta pushtojë një ndjenjë tjetër, ndryshe nga shqetësimi që kishte provuar në fillim të ndeshjes. Kjo ishte ndjenja e ngazëllimit për këtë barazim prestigji të njëllojtë me një fitore të arritur kundër një skuadre aq të fortë dhe aq pretendonjëse. Vrente tani futbollistët shqiptarë që shkelnin mbi barin e gjelbër, siç shkelnin ngadhnjmtarët në qilimat e gjelbër që shtrojnë të mundurit, ndërsa atij i dukej se bashkatdhetarët e tij po shtypnin edhe megakomaninë e dinjitetin e shtirë të atyre që i kishin vështruar me aq përçmim, e që tani po linin stadiumin të heshtur, kokulur dhe të zhgënjyer.

Shqipëria edhe pas kësaj ndeshjeje ishte përsëri në krye të këtij turneu ndërkombëtar.

Futbollistët shqiptarë i bënë shenjë me dorë. Dhe ai, duke folur, hapi krahët, si të donte t'i përqafonte. Me dorë ja bënë dhe shqiptarët që vazhdonin të duartrokisnin mbi shkallët e stadiumit. Ai pushoi pak për t'i lënë të dëgjoheshin më qartë ato thirrje të shqiptuara në gjuhën shqip që po sulleshin me vërtik nëpër qindra e qindra kilometra e shpërthenin në radiot e Shqipërisë, ku bashkatdhetarët me siguri po thoshin: «U lumtë. Me të vërtetë na nderuan! Ata përsëri mbetën në vendin e parë.

RRETHI

Sajmirin nuk e zë gjumi.

Ka një orë që është shtrirë, por megjithatë gjumi nuk e zë. Po shokët flenë. Edhe kapanoni flë. Fle edhe reparti kufitar në këtë krahinë jugore të Shqipërisë.

Ndërsa kufitarë jashtë; pranë piramideve, pas drurëve, rrëzë shkëmbinjve, si shkëmbinj qëndrojnë.

Dëgjohet një frymëmarrje e rëndë. Shoku që fle pranë tij lëviz, diç, thotë nëpër gjumë, ca fraza të shkëputura dhe kthehen nga ana tjetër.

Është Shpendi. Për tre muaj ai mbaron sherbimin ushtarak e do të shkojë në fshatin e tij, në mes të bjeshkëve të veriut. Është djalë i mirë, i çiltër, hokatar, por dhe zemrak.

Dhe këtë radhë është zemëruar. Dhe me kë? Me ushtar Sajmirin. S'i ka ikur ende zemërimi. Si kështu?

Po ja... Një ditë më parë ishin zhvilluar ndeshjet e mundjes sambol¹⁾ për garat brenda re-

1) Një lloj mundjeje sportive.

partit. Skuadra, komandanti i së cilës është Shpendi, kish fituar në tërheqje litari, në ushtrimet gjimnastikore, po në mundjen sambo...

Këtu gjithshka u prish.

Siç duket, për faj të Sajmirit. Se ai humbi ndeshjen vendimtare. Po ç'të bënte? Luftoi shumë, por kundërshtari, një malësor i ngjeshur si lis, që shumë i shkathët. E përmbysi mbi tapet. Njëri nga të dy do të humbiste doemos. Dhe humbi Sajmiri.

Është muaji i pestë që ai po kryen shërbimin ushtarak në këtë repart kufitar. Gjatë tre muajve të para në shkollën e instruksionit ai u njoh nga pak me të gjitha. Mësoi dhe mundjen sambo. Fizikisht Sajmiri është shumë i fortë. S'i linte gjë mangut atij malësori. Mirëpo ai e mundi. Ndoshta sepse është pak më i vjetër si ushtar (kryen vitin e dytë), ndoshta se u tregua më i vëmendshëm, po puna është se e mundi.

Skuadra e tyre humbi një pikë. Dhe për dreq kjo pikë u bë shkak që në klasifikimin e përgjithshëm skuadra e ushtar Shpendit, të mos zinte vendin e parë.

Ec e merru vesh tani me të!

— Të kishe luftue, he burr i dheut!

— Si nuk lëftova?... Ti e pe vetë

— Nji atëhere që e kape për krahu, ta kishe ngritë e fap ta kishe shkapetë për tokë!

— Më shpëtoi duarsh!

— Hë, pra, një për këte po due me të folë. Të mos e kishe lanë. Po të kishte qenë ndonji thyes kufini? A e din çka kishte me ndodhë?...

Duke thënë këto fjalë, Shpendi tundi dorën e madhe, të madhe si krahun, si trupin. Megjithëse

i gjerë e i bëshëm si një copë e madhe shkëmbi, Shpendi ishte i zhdërvjellët. Kundërshtarin e vet, një ushtar tjetër pothuaj si ai, e përmbloodhi, e ngirti nga toka dhe e rrëzoi, si të shkulte një trumg me gjithë rrënjë e ta vërtiste poshtë. E gjitha kjo ndodhi brenda një minute.

Kështu ka ngjarë...

Shpendi fle. Edhe shokët e tjerë flenë. Vetëm ushtar Sajmiri nuk flë. Veç të bëheshin prapë ndeshjet e tjera të mundjes Sambo! Po dhe të mos bëheshin shpejt, kishin për të parë shokët gjatë stërvitjeve së cili ish Sajmiri.

«Sa ka shkuar ora? Kushedi! Do të ketë kapërxyer dymbëdhjetën...»

Mendimet venë larg në sheshin e gjerë të qytetit... Në shtëpi, nëna dhe babai flenë. Fle dhe Fatosi i vogël.

Edhe shokët e punës duhet të flenë. Po mund të jenë duke punuar. Ka më shumë se dy orë që ka filluar turni i natës. Tornot gumëzhjnë.

Edhe Zana duhet të jetë duke punuar. Tani me siguri do të ketë prodhuar ndonjë detal të ri. Po të ishte ai, me siguri, me të mbaruar së punuari detalin, do t'i afrohej, duke buzëqeshur, do t'i thoshte:

— E, si duket, e kam punuar mirë?

— Po, po, Zana. Vetëm ki kujdes te numri i rrotullimit të mandrinos.¹⁾ S'duhet më shumë se 300 në minutë.

Sajmiri kthehet nga ana tjetër e shtriqet, si të kish parë një ëndër të bukur.

... Të mos e kish humbur këtë ndeshje.

1) Mandrino quhet koka e tornos.

Me siguri që do ta kish zënë gjumi. Dhe atëhere do të shihte ëndërr edhe qytetin, edhe prindërit, shokët. Edhe Zanën. Kurse tani rri zgjuar. Edhe sa kohë kështu. As ai vetë s'e di. Kurse tani rri zgjuar. Edhe sa kohë kështu. As ai vetë s'e di.

Si padashur qepallat i rëndojnë. Edhe pak e do të mbështetet në krahët e gjumit. Edhe pak.

Por...

Një goditje e fortë çange. Edhe disa të tjera.

Ushtar Sajmiri ngrihet. Edhe ushtar Shpendi, që fle pranë tij. Të gjithë ngrihen.

— Alarm, shokë!

— Çohuni! Të gjithë te armët!

Nga kufiri lajmërojnë: Një grup thyesish të kufirit, i përbërë prej pesë vetash, ka kaluar kufirin e, duke përfutur nga nata pus e zezë, kërkon të depërtojë thellë.

Urdhërohet: «T'u zihen prita në të gjitha shtigjet. Me të gjitha mjetet të kapen të gjallë... Të asgjësohen vetëm në pamundësi për t'u kapur».

Të gjithë, dy nga dy, shpërndahen në drejtim të pritave.

Sajmiri dhe Shpendi janë bashkë. Rrëmbejnë në pushkët automatike e vihen në udhë.

Drejt Shtegut të dhëve...

Të arrijnë sa më parë, sa më parë!

Se ndoshta banditët mund të kenë kaluar. Mund edhe të jenë duke u kthyer, se kanë vënë re që shtigjet janë të zëna.

Ku i dihet?

Pra, përpara!

Më së fundi ja dhe Shtegu i Dhëve. Qëndrojnë. Një gur rrokulliset me uturimë nga

shkëmbinjtë që ngrenë shtatin e rrudhosur në errësirë.

Ç'mund të jetë? Kush fshihet në errësirë? Heshtje.

Ata shtrihen e presin.

«Ta kishe fitue, bre burr i dheut, atë ndeshje!».

Sajmirit përsëri i tingëllojnë në vesh këto fjalë të Shpendit.

Errësirë.

Ndjen trupin t'i ftohet. Djersët mbi fytyrë po i thahen, madje sikur po i ngrijnë. Rrobat, që i ngjiten pas trupit, po avullohen.

Bën shumë ftohtë. Acar. Thëllim, megjithëse është fillimi i nëntorit e dëbora ende s'ka filluar të bjerë.

Sajmiri mbështillet, afron më pranë pushkën automatike dhe përgjon.

Tani ndoshta Zana shtrëngon nofullat e mandrinos; fshesarët nëpër rrugë kanë filluar të pastrojnë rrugët, vëllai i vogël Fatosi, po buzëqesh duke parë ndonjë ëndërr të bukur.

Edhe pak dhe qyteti i tij i dashur do të zgjohet e do të përqafojë agimin...

Jeta do të fillojë të lëvrijë nëpër trotuaret, nëpër rrugët, nëpër shkollat, fabrikat, siç lëvrin gjaku në një trup të fortë e të shëndoshë.

Por edhe këtu, nëpër këto monopate, mund të zvarriset si fantazmë, si hije, armiku me dhëmbë të nxjerra jashtë, armiku, që kërkon të dëmtojë dhe, po të mundet të vrasë jetën kudo, edhe në qytetin e tij të lindjes, prandaj duart duhet të shtrëngohen më fort pas hekurit të ftohtë,

prandaj sytë duhet të çajné sa më thellë errë-sirën që mbështjell Shtegun e Dhenve.

Nga mund të vijë armiku? Të ketë kaptuar Shtegun e Dhenve?

Shokët kanë zënë pritë më poshtë. Po të jetë kështu, atëhere armiqtë do të zbrapsen e s'kanë nga të kalojnë veçse nga Shtegu i Dhenve.

Po ja, disa krisma që ndjekin njëra-tjetrën, që shuhen e dëgjohen përsëri më fort, më dendur.

Tani një buçimë krisdash që trondisin pyllin, shkëmbenjtë.

Thyesit e kufirit kanë ndeshur diku me shokët dhe s'duhet të jenë shumë larg.

Sajmiri s'e përmban veten. Kërkon të ngrihet. Të vrapojë drejt shokëve. Atje ku luftohet.

Po Shpendi i bën shenjë të qëndrojë. Fytyra e tij është ngrysur. As edhe një ditë më parë, pasi kish humbur ndeshjen, fytyra e Shpendit nuk kish këtë shprehje.

Sajmiri i dallon mirë tiparet e fytyrës së shokut, sepse tani dhe ka filluar të agojë.

«Asnjë lëvizje!» — flasin sytë e Shpendit. «Duhet zbatuar urdhëri. Thyesit mund të kalojnë këndeje nga çasti në çast».

Kufiri ka shumë shtigje.

Shtegu i Dhenve është nga më pak të rrahurit, ndoshta më pak të rrezikshmit, sepse është shumë i gjerë.

Prapë krisma të forta si të parat. Dëgjohen këmbë që trokëlljnë. Hapa të shpejta kaptojnë kodrës së pjerrët drejt Shtegut të Dhenve.

Më së fundi dallohen siluetat e tyre. Janë dy

shkelës kufiri. Dhe sa mirë janë maskuar! Janë veshur si fshatarë. Vështirë t'i dallosh se janë armiq, po t'i shohësh në një ditë të zakonshme, kudo qoftë. Tamam fshatarë të zakonshëm. Po në duar ama duhet të kenë armë. Me ato kanë qëlluar shokët, me ato do të qëllonin këdo që do t'u dilte përpara.

Vetëm njëri ka armë në duar, një pistoletë. Tjetri, me sa duket, e ka hedhur, për të qenë sa më i lehtë, për t'ja mbathur sa më shpejt. Se, kur zbrapsen thyesit e kufirit, i lënë të gjitha, vetëm të shpëtojnë kokën. Prandaj sa më shpejt!

Marrin nga e majta e Shtegut të Dhenve. Janë rreth tridhjetë metra larg tyre.

— Ndal!

— Ndal!

— Duart lart! Dorëzohuni!

Të dy shkelësit e kufirit dridhen e puthisen rrafsh me tokën.

«Nga vijnë këto zëra? Si t'i ndillte nëntoka!»

— Ngreuni! Hidhni poshtë armën! Dorëzohuni!

— Armën poshtë se do të qëlloj...

Shpendi dhe Sajmiri s'e kanë vështirë të qëllojnë; po atëhere armiqtë do të kositeshin.

Por ata duhet të kapen të gjallë.

Nga larg dëgjohen krisma. Prapë po luftohet. Armiqtë mund të asgjësohen gjatë kësaj përpjekjeje.

Mund të mos mbesë gjallë asnjë. Të vriten atëhere dhe këta të dy? Kjo s'ka kuptim. Duhet kapur të gjallë, aq më tepër që vetëm njëri ka armë e tjetri është fare i çarmatosur.

Shpendi bën një lëvizje.

— Dorëzohuni!

Thyesi i kufirit me pistoletë e ka diktuar këtë lëvizje dhe papritur qëllon një herë, dy, tri, në drejtim të Shpendit, andej nga vijën zërat. Plumbat fishkëllojnë mbi kokë. Sajmiri matet të qëllojë mbi ta.

E di shumë mirë se në të tilla raste duhet të qëllojë në këmbë për t'i plagosur, për të mos i lënë të ikin.

— Mos shtjerë! — urdhëron Shpendi. — Do t'i kapim të gjallë. S'kanë nga ikin. Sajmiri shtrëngon dhëmbët.

Shpendi nuk ka besim, siç duket. Mos mendon se ai, meqë bie për herë të parë në pritë, druhet ose, më keq trembet, e mos ndoshta automatikisht i dridhet në duar?

Atëhere plumbat mund të godasin në pjesën e sipërme të trupit e gjithshka dështon.

«Kështu e dashka», mendon Shpendi. Po as vetë nuk po qëllon.

Po pse hesht armiku? Shpendi ndërron vend me një lëvizje të rreme. Edhe një krisëm!

Pistoleta, që vjell zjarr drejt tij, lëshon vetëm një kërcitje të thatë.

Asgjë më shumë.

Këta ishin plumbat e fundit. Pistoleta s'ka ç'i duhet më atij. Ky është fundi.

Po armiku s'e shet lëkurën lirë.

— Dorëzohuni!

Ata po zvarriten nga prapa. Kanë disa shkëndija shprese për të shpëtuar.

— Mbi ta! — urdhëron Shpendi.

Dhe hidhen.

Dy armiqtë ngrihen e ja japin vrapit në drejtime të ndryshme: njëri merr drejt kories, që të shpie në kufi. Tjetri sulet përmes shkëmbinjve. Pas tij sulet Shpendi. Sajmiri ndjek atë tjetrin.

Ç'vrap i çmendur! I është afruar shumë. Po sikur ta vrasë? Jo, jo, duhet kapur i gjallë. I është afruar shumë, aq sa dëgjon frymëmarrjen e tij.

— Ndal!

Dhe tjetri ndalet. Bën një kthesë të rrufeshme e në një sekondë, pa u kuptuar, diç nxjerr nga brezi. As pistoletë, as granatë, por një thikë të ndritshme, të mprehtë. Kjo është krejt e papritur. Ai bëhet gati të qëllojë: Sajmiri sulet mbi të, i shtrëngon dorën. Është një shtrëngim i tmerrshëm. Thyesi i kufirit mezi përmban një klithmë të mbytur dhe lëshon thikën. Po ndërkohë bën një përkulje përpara dhe, duke lëvizur, i jep një të shtyrë Sajmirit. Ai nuk arrin ta përmbajë veten dhe rrëzohet. Thyesi i kufirit kërkon të rrëmbejë thikën, që ka mbetur diku aty pranë, po Sajmiri, ashtu i rrëzuar, i jep një të shtyrë me këmbë sa ai përmbysset.

Të dy kanë mbetur të rrëzuar. Po që të dy ngrihen dhe sulen kundër njëri-tjetrit ashtu si në mundjen sambo.

«Kjo është ndeshje për jetë a vdekje» mendon Sajmiri.

Tani janë mbërthyer trup më trup. Thyesi i kufirit është trupbëshëm, i fortë. Ndjen afshin, dihatjen e tij. Kujton Shpendin, ndeshjen, që kish humbur.

«Po sikur ta humb këtë ndeshje? Sikur...»

Thyesi i kufirit gulçon, dridhet një çast, po rishitas kërkon ta mbërthejë. Rrokullisen teposhtë pranë një trangu peme. Pastaj ngrihen. Thyesi i kufirit rrëmben një copë dru dhe kërkon ta godasë. Shkopi ngrihet lart e pas pak do të bjerë mbi kokën e tij. Po Sajmiri dredhon.

«Ç'mundje është kjo... Këtu duhet të dal fitimtar. Apo jo, Shpend? Ku je ti?»

Ja mbërthen dorën, ndërsa me tjetrën i jep një goditje, pastaj një tjetër. Thyesi i kufirit lëkundet, po nuk rrëzohet. E përfshin pastaj me krahët e fuqishëm. E shtrëngon fort. Dhe duart, si një rreth i hekurt, ngushtohen në trupin e bëshëm të armikut që rënkon, hap gojën dhe zgurdullon sytë. Është shtrirë sa gjatë gjerë, si një kundër-shtar i rrëzuar me shpatulla mbi tapetin e mundjes sambo.

Edhe një goditje e fortë në kokë dhe ai mbetet i tulatur.

Prej diku, përmes shkëmbinjve, vjen jehona e një klithme, që humbet thellë greminës.

«Po kjo, ç'është kjo?» Dikush ka rënë teposhtë. Cili vallë?»

Sajmiri kërkon të ngrihet, të shohë ç'bëhet me Shpendin. Por duhet të qëndrojë mbi armikun.

Dëgjoheh hapa. Ato afrohen gjithnjë drejt tij.

«Mos janë armiqtë?» Shtrëngon pushkën automatike. «Por jo, qenka Shpendi me shokët».

Sajmiri dëgjon zërat e tyre. Edhe zërin e Shpendit. E sheh atë midis tyre.

Tani Shpendi po vrapon drejt tij, duke u bërë shokëve me dorë. Fytyra i çelet tek e sheh mbi armikun.

— E paske mbërthyer mirë, Sajmir!

— Po Shpend! Tjetri ç'u bë?

— Gjeti atë që meritonte. Rrëshqiti poshtë shkëmbinjve. Ti e paske rrëzuar. E shikon?

Shokët i hedhin një vështrim miklues.

— Kjo është ndeshje, kësaj i thonë të mundur!
— thonë ata.

— Keni hak ju! — përgjigjet Shpendi. — Sot Sajmiri fitoi një garë të madhe që ja kalon edhe mundjes sambo.

Ai vështron me miratim Sajmirin, që vazhdon ta shtrëngojë trupin e mundur të armikut.

VDEKJA E ÇIKLISTIT 1)

Kjo ishte etapa më e vështirë e turit: rruga mbështillej si gjarpër në qafën e malit të Vantusë, maja e të cilit ngrihej ogurzezë në sfondin e kaltër të qiellit. Ashtu ajo dukej si koka e një kafshe prehistorike, e gatshme të kafshojë shpatullat e hirta të maleve, që humbisnin në horizontin e mjegulluar të asaj pasditeje të nxehtë korriku.

«Vantuja — mendonte mister Benksi, duke vështruar përmes dritares së hotelit atë copë horizonti të përflakur nga dielli, që zbulonte para syve të tij vargmalet e heshtura, të ftohta e hijerënda. — Vantuja, gracka e çiklistëve. Ajo është me të vërtetë si përbindsh. Luftohet me përbinshin? Njëpër udhën e lakuar përmes shkëmbinjve të thepisur, si rrugë skëterre, që ngrihej 1700 metra mbi nivelin e detit, mbeteshin dhe tër-

1) Ky tregim është shkruar sipas një fakti të vërtetë: në korrik të vitit 1967 vdiq gjatë Rrethit Çiklistik të Francës, (Tur të Frans), çiklisti profesionist anglez, Tom Simson. Vdekja iu shkaktua, ngaqë kishte përdorur doping (preparat mjekësor që përdoret për ngacimin e sistemit nervor dhe të muskulaturës së sportistit).

hiqeshin një pjesë e çiklistëve. Të tjerë këtu humbisnin minutat më të çmuara, humbisnin dhe vendet më të mira në klasifikim, ndoshta për të mos i fituar kurrë më. Kështu do të ngjiste dhe me Soni Tomsonin. Edhe atë, si të tjerët, do ta gëlltiste përbindshi Vantu...»

Po nuk pati kohë të mendonte më gjatë, sepse në atë kohë ndjeu të trokitura në derën e dhomës së tij. Ishte vetë Soni Tomsoni. Ky, me sa duket, sapo ishte çuar nga gjumi e, megjithëse ishte çlodhur për gati dy orë, dukej i zbehtë dhe i kapitur.

— Më thirrret, mister Benks? — pyeti.

— Po, Soni, dua të bisedoj me ty. Si e ndjen veten?

— Mirë, po etapa e sotme qe tepër e gjatë.

— Ke të drejtë, po e nesërmja do të jetë edhe më e gjatë, etapë malore. Shikoje Vantunë si duket së këtejmi!

— E di, mister Benks. Vantuja është etapë e vështirë, ndoshta më e vështira nga të gjitha etapat e çiklizmit profesionist.

— Për këtë dhe të kam thirrur.

— Unë do të luftoj. Jini i qetë, — foli Soni.

— Të kuptoj drejt — u përgjegj mister Benksi, duke i bërë shenjë të ulet. — Po ngandonjëherë edhe kur lufton, njeriu nuk ja arrin qëllimit. Mos harro se, me gjithë të dhënat e shkëlqyera fizike, ti nuk je skalator i mirë¹). Tani je i pesti në klasifikimin e përgjithshëm. Pas Vantusë do

1) Skalatorë quhen çiklistët e specializuar në ngjitjen e etapave malore.

të rrukullisesh edhe më poshtë, ndërsa unë kisha parashikuar që ti të ngjiteshe lart e më lart.

— Mister Benksi, që para fillimit të Turit të Francës ju paralajmërova se nuk isha në gjendje të mirë fizike. Unë edhe tani nuk e ndjej veten mirë. Por ju, ju më detyruat. . .

— Unë nuk të detyrova, Soni, po ti ishe i detyruar të merrje pjesë.

— E kuptoj ç'doni të thoni... kontrata, paratë. Po më tepër unë nuk mund të bëj, të më besoni, nuk mundem.

Pas këtyre fjalëve Soni u ngrit me rrëmbim nga vëndi e filloi të lëvizë nëpër dhomë.

— Mos folë ashtu, Soni. Çështja është se duhet bërë diçka. Ti nuk duhet të mbetesh në vendin e pestë. — i foli me butësi mister Benksi.

— Pandehni ju se unë nuk dua të zë vendin e parë? Po çfarë mund të bëj?

— Ti dhe vendin e parë mund ta zësh, Soni.

— Ç'thoni ashtu!

— Dëgjo, Soni. Unë kam menduar për ty. Po dhe ti duhet të mendosh pak për mua. Gjyko se tani në fabrikën time po prodhohen me mijëra brisqe me portretin tënd. Po sikur ti të mos zije vend të parë, ose të paktën të dytë ose të tretë, si thua, a do të kujtohej njeri të blente brisqe me portretin e një çiklisti që është klasifikuar i pesti apo i dhjeti?

— Përse jeni ngutur, mister Benks? — u habit Soni. — Po megjithatë ka kohë. Ju mund ta hiqni atë portret nga brisqet.

— Tepër vonë, Soni. Brisqet, që po prodhohen tani, mbajnë markën «Simson».

Soni kapsalliti sytë dhe mbeti i shtangur.

— Po më falni... çfarë mund të bëj për ju? Kjo është një gjë që s'varet nga unë. Jua përsëris: në Vantu do të luftoj. Kini për të parë si do të luftoj.

— S'mjafton kjo, Soni.

— E di — pohoi me keqardhje Soni. — Në Vantu do të ma kalojnë skalatorë më të fortë. Po hë, pra, thuajmëni, çfarë mund të bëj?

Mister Benksi e vështroi drejt e në sy Sonin e, duke i shqiptuar fjalët ngadalë, tha me një ton të prerë:

— Ka një rrugë, Soni.

— Mos e kini fjalën për gregarët¹⁾ e mi?

— Jo, Soni. Kam menduar diçka tjetër. Vështro këtu! — dhe i zgjati një tubet në ngjyrë të gjelbër.

— Po kjo, ç'është kjo?

— Mos u habit. Ti duhet ta kuptosh; amfetaminë e një tipi të ri. Mjafton të pish disa kokrra nga kjo dhe atëhere Vantuja do të të kthehet në fushë.

Këtë radhë Soni u ngrit nga vendi shumë i zbehur.

— Doping? Ju kërkoni që unë të përdor doping? — tha duke zvarrisur fjalët.

1) Gregarë quhen ata çiklistë që i ndihmojnë çiklistit më të mirë të ekipit të tyre, duke i prirë për të penguar erën dhe për ta nxitur të rritë shpejtësinë.

— Qetësohu, Soni! Këtu nuk ka asgjë të jashtëzakonshme. Të gjithë çiklistët përdorin doping ... Po... të kuptohemi: unë shtrëngohem ta bëj për të mirën tënde.

— Për të mirën tuaj më mirë.

— Hëm, natyrisht edhe për të mirën time.

— Mister Benks, unë jam një sportist i ndershëm, ndaj dhe lavdinë sportive dua ta fitoj në rrugë të ndershme.

— Si, nuk do ta përdorësh?

— Kurrë!

— Mos ndoshta trëmbesh se mos të të ndodhë diçka?

— Edhe ajo mund të ndodhë. Vallë pak çiklistë kanë vdekur gjatë këtyre viteve nga përdorimi i dopingut? Nuk do të doja kurrë që, pasi të bënin autopsinë e kufomës sime, mjekët të deklarorin se Soni Tomsoni vdiq, meqë kish përdorur doping.

— Përse tregohesh fatalist, Soni?

— Mund të mos ndodhë kjo, po mund të ndodhë që pas garës të bëjnë kontrollin antidoping.

— Mos u shqetëso, Soni! Do të përpiqem që ti t'i shmangesh këtij kontrolli.

— Jo, mister Benks. Ç'rëndësi do të kishte atëhere për mua vendi i parë?

— Do të të paguaj, Soni!

— Mjaft! Në djall të veni me gjithë paratë tuaja. Unë nesër do të përpiqem, do të luftoj. Ndonëse jam i lodhur, ndjej forca në veten time. Por dijeni se këtë nuk do ta bëj për ju.

Bile me të mbaruar Turi i Francës, do të prish çdo kontratë me ju.

Pasi tha këto fjalë, Soni doli me vrull nga dhoma, duke e lënë mister Benksin të shtangur.

«Po tani, si do t'ja bëj tani?» tha me vete mister Benksi. «S'bindet ky kokëshkëmb. Na qenka sportist i ndershëm! Por megjithatë do të shohim.»

* * *

Karvani i zvergur i çiklistëve, si një zvaranik gjigand po ngjitej e ngjitej rrugës malore, që shtrihej në këmbë të Vantusë.

Kish filluar pjesa më e vështirë e etapës. Tami rruga kalonte në mes dy shkëmbenjve të thepisur, që u përngjanin dy nofullave të hapura. Për një çast Sonit i duket sikur ata do ta përtypin atë vetë.

Ai pedalonte pas gregarëve të tij, që herë pas herë ndërroheshin; pedalonte dhe linte pas çiklistët me fytyrat e dirsura, që ngulçonin, shtrëngoheshin pas biçikletave, për t'u ngjitur gjithnjë lart.

«Sa fytyra të shëmtuara!» mendonte. Me siguri dhe fytyra e tij ashtu ishte shëmtuar. Edhe ai si ata ngulçonte, ndonëse nuk e ndjente veten aq të lodhur. Këtë nuk e kish menduar. Kishte gjuvuar se Vantuja, si përbindsh, do ta gëlltiste. Ndërsa tani po ngjitej në qafë të saj. Vërtet me vështirësi, po sidoqoftë po ngjitej.

Ku i gjente vallë këto forca?

«Më fort, më shpejt!» thoshte me vete dhe, duke ndjekur gregarët, që çanin përpara, linte

pas çiklistët me fytyra të lodhura e të shtrembëruara. Ndoshta, duke pedalar kështu, edhe mund të dilte në krye. Tani para tij ishin vetëm nja dhjetë çiklistë. Kishte lënë prapa dy nga kundërshtarët e tij që qenë ndër të parët në klasifikimin e përgjithshëm: italianin Manceli dhe francezin Benglar. Po në krye mbetej belgu Van Himst.

«Më fort, më shpejt».

Ndoshta mund të dilte dhe i pari ai, Soni Tomsoni, në një etapë malore si ajo e Vantusë. Do të gëzohej atëhere mister Benksi. Ai u vrenjt për një çast.

«Jo, mister Benks! Unë nuk dua të dal më i pari për ty, pa çka se ti po prodhon brisqe me portretin tim».

Po kalonin motoçiklistët e policisë rrugore, që shoqëronin çiklistët. Pastaj me radhë maqina e ndihmës mjekësore, maqina e shtypit, e padronëve, që organizonin Turin e Francës. Midis këtyre ishte dhe mister Benksi, që po e vështronte buzagas, thuase midis tyre s'kish ngjarë asgjë. Soni uli kokën për t'iu shmangur vështrimit të tij, shtrëngoi dhëmbët dhe filloi të shtonte shpejtësinë.

Rruga tani shkiste përmes shkëmbinjve si nofulla; aty-këtu ishte e sheshtë, kështu vazhdonte për disa qindra metra, po në kthesat ngjitej e kurrë nuk zbriste teposhtë. Marceli, Benglari dhe Van Himsti po zhdukeshin nga sytë e tij.

«Më fort, më shpejt. Duhet arritur ata të tre».

Dielli përmes reve të trubullta digjte nga sipër. Asfalti i rrugës zbutej e shkrihej. E kish marrë etja. Me dorën që i dridhej, mori termosin

e vogël mbi timon. Por u habit, kur pa që ishte boshatisur. Si ishte e mundur! Po ai këtë s'e kish përdorur fare. (Tjetrin e kish boshatisur nga mesi i garës). Thua t'ja kishin dhënë të pambushur me pije freskuese? Si ishte e mundur! Vetë mister Benksi ishte interesuar që çiklistëve të firmës së tij t'u jepeshin sa më parë pijet freskuese.

Mendoj t'u kërkonte gregarëve të tij, po ata tani i kishte lënë prapa. Disa dhjetëra metra para tij ishte një çiklist. Mund t'i kërkonte dhe atij. Po thua do t'i jepte ai? E dinte se në garë midis çiklistëve një gjë e tillë është e rrallë, bile e pamundur. Në garë ata shikoheshin gjithnjë si ujqër.

Kishte lënë shumë prapa dhe maqinën e mister Benksit. Të priste? Po kështu ai do të humbiste kohë.

«Më fort, më shpejt!..»

Koha po prishej. Retë shtyheshin e ngjesheshin. Dielli nuk dukej gjëkund. Filloi të fryjë erë. Koka e Vantusë gjëmoi si krater vullkani. Po fillonte shiu.

E ndjeu veten më të lehtësuar. Era e freskët që i ledhatonte fytyrën, sikur po ia hiqte lodhjen. Por edhe po e pengonte. Ajo nga çasti në çast i përplasej në fytyrë e ai, ca nga era e ca nga ngjijtja e lodhshme, dukej se nuk bënte asnjë metër përpara.

«Ah të kisha tani gregarët! Ku janë!» Po ata kishin mbetur shumë prapa, kurse tre të parët po vidheshin nga sytë e tij. Kishte pasur mundësi t'i arrinte dhe t'i kalonte. Dhe ndoshta përsëri mund t'i kalonte.

«Po mister Benksi ku është? Pse po vonohet?»

Kurrë nuk e kishte menduar se do të tregohej kaq i fortë në ngjitjen e tmerrshme të Vantusë. Mos ndoshta kundërshtarët e tij nuk ishin në formë? Ç'është e vërteta, nja dhjetë çiklistë kishin kohë që e kishin lënë garën. Po këta ishin nga ata që nuk prishnin punë. S'duhet t'i linte ata tre të parët t'i zhdukeshin. Por po e mundonte etja.

Filloi dhe shiu. Një shi i vrullshëm, që pasohej me gjëmime e rrufe. Ndjeu një përtëritje të çuditshme, megjithëse tani e kishte dhe më vështirë të çante përpara. Filloi të bjerë dhe breshër. Koha po ftohej. Qielli i nxirë po ulej gjithnjë më shumë. Vantuja kishte humbur nën perden e rëndë të reve.

Çiklisti përpara tij mbeti. Ky ishte belgu Van Himst. S'mund të bënte një hap përpara. Dukej sikur kishte ngrirë. Edhe ai ishte tërhequr. E vështronte me përdëllim, sikur t'i lutej ta ndihmonte. Por Soni as që po kujtohej për të. Tani nuk dinte si të ndihmonte veten e tij. Ndiente se muskulatura po i ftohej. Ngjitja po bëhej gjithnjë më e vështirë, kurse ai ishte i vetëm midis shiut e breshërit dhe të ftohtit. Mos do të pësonte fatin e Van Himstit?

«Më fort Soni, më fort...»

Po këmbët s'i bënin. Pështyma i kish mbetur në fyt. Buzët i dridheshin. «Ah kjo ngjitje e mallëkuar! Kur do të mbarojë. Kjo është një garë skëterre. Ç'është nevoja të zgjidhej Vantuja, ky përbindsh i pamëshirshëm?» Herë pas here përmes reve, që vraponin si tufat e kaprojeve kur dëgjojnë gjësimin e furtunës, shihte kokën e murme të Vantusë, që dukej se po përkulej dhe më tepër drejt tij. «Përse kjo garë? Po është e kuptueshme.

Organizatorët e Turit të Francës duan sensacione, gara mbinjerëzore. E këtë e bëjnë në kurrizin tonë».

Edhe ai po mbetej. Ndoshta dhe mund të mbetej fare. Do të detyrohej të tërhiqej, atëhere kur kishin mbetur dhe tri etapa. «Mallëkim, mallëkim, mallëkim. Kjo nuk duhet të ndodhë. Atëhere unë do të jem vërtetë i humbur!»

Soni e mori biçikletën në krahë e filloi të vrapojë. Shiu vazhdonte të binte. «Sa të kaloj dhe këtë të përpyetë, se pastaj rruga vjen e sheshtë. Durim, Soni, durim edhe pak minuta! Ja, po arrin».

Kishte dhe raste që çiklistët vepronin kështu. Kjo ndodhte kur nuk kishin rrugë tjetër.

Nga pas dëgjoi borinë e një maqine. Vinte mister Benksi.

— Soni, ç'pate kështu? Hip në biçikletë!

Po Soni s'kishte fuqi t'i fliste.

Nga maqina u zgjat një dorë.

— Merre, Soni, këtë, pije! Mos e humb. Përpara tani. Ti mund t'i arrish tre të parët. Edhe i pari mund të dalësh!

Ishte një nga përfaqësonjësit e firmës së mister Benksit që fliste kështu.

Soni rrëmbeu nga ajo dorë termosin dhe filloi të gëlltisë me gllënqka të mëdha. Në termos kishte çaj të ngrohtë. Në çast ndjeu një ndryshim në organizmin e tij, atë ndryshim që ndjen njeriu kur pi konjak në ditët e ftohta të dimrit. Gjymtyrët po i çmpiheshin.

— Përpara tani, Soni! — i lutej mister Benksi.

Dhe Soni, pasi hipi në biçikletë, u shkëput përpara.

Pas çdo lëvizjeje të këmbëve ndjente t'i shumëfishoheshin fuqitë. Ky kishte qenë shpëtimi. Mund të kishte humbur kot. Po, ndonëse vonë, mister Benksi kishte arritur. E kishte kaluar krizën.

Shiu kishte pushuar. Perdja e rëndë e reve po shqitej duke lënë të shfaqej koka e mjegulluar e Vantusë, që tani nuk ju duk më si një përbindsh. Vantuja po mbetej prapa në rrugën që vazhdonte të shtrëngohej në qafën e saj si të donte ta mbyste. Prapa kishte mbetur dhe karvani i çiklistëve, dhe belgu Van Himst, që ishte tërhequr, edhe maqina e mister Benksit.

Dielli derdhte lëmshe të zjarra drite. Koha, që aq shpejt ishte ftohur, Tani po ngrohej, bile po nxehej. Kurse ai po çante gjithnjë lart. Nga pas dëgjoi përsëri boritë e makinave. Ishin studiut lëvizëse të radios dhe të televizionit, që kishin filluar transmetimin e radiokronikave të zakonshme sportive. Etapa po i afrohej fundit. Kjo e përmendi, e ngacmoi dhe e shtyri të shtonte shpejtësinë. E dinte tani se kamera televizive ndiqte çdo lëvizje të tij dhe se telekronistët dhe radiokronistët komentonin, në do të mundej t'i arrinte dy çiklistët që ishin shkëputur.

«Më fort, më shpejt». Ai u përkul mbi biçikletë. I pa ata në kthesë të rrugës, që tani shtriheshin drejt. «Edhe pak dhe do t'i arrij!»

Habitej me veten e tij. Ç'kapitje kish ndjerë, ç'ngarkesë të madhe kish mbajtur mbi shpatulla, kurse tani i dukej se po fluturonte...

Rruga vazhdonte të ishte e sheshtë, fushore. Dhe në rrugë fushore ai ishte i pakalueshëm.

Arrijti italianin Manceli dhe francezin Benglar. Pastaj dhe i kaloi. Po duhej t'u shkëputej shumë, duhej të fitonte të paktën tre minuta dhe pastaj... pastaj do të vishte fanellën e verdhë¹⁾. Do të bënte kështu të papriturën më të madhe të Turit. Dhe s'do ta hiqte fanellën e verdhë, sepse etapat e tjera qenë fushorë, qenë etapat e tij.

Kishte qenë aq afër fitores dhe me gjithë përvojën nuk e kishte kuptuar. Bile dhe e kishte nënçmuar veten. Kurse mister Benksi i kishte propozuar të përdorte doping. E ç'ishte nevoja të përdorte atë, përderisa ai ishte në gjendje të ngjitej lart me forcat e tij?

«O zot, o Shën Mari! Kush m'i dha këto forca?» Ai bëri kryq e ngriti sytë në gjirin e pafund të qiellit, si të donte të kërkonte mirënjohje. «Thua zoti?...»

Në sfondin e përhimtë të kodrinave, që zbuteshin duke u ulur në një fushë të gjelbëruar, dalloi shtëpitë e afërme të qytetit. «Ja dhe fundi! Edhe më shpejt!»

Dy çiklistët e tjerë s'dukeshin gjëkund. Sig duket, i kishte lënë shumë prapa. Nga pas nuk i ndaheshin studiot lëvizëse të radios dhe televizionit. Ai vazhdonte të ishte gjithnjë i pari. Por duhej të shkëputej sa më shumë, duhej të fitonte sa më shumë minuta nga kundërshtarët e tij...

1) Fanella e verdhë vishet gjatë Rrethit Çiklistik të Francës nga çiklisti, që pas do etape, qëndron në krye të klasifikimit të përgjithshëm.

U përku! dhe më shumë mbi biçikletë.

Mirëpo papritur ndjeu një pickim të fortë në zemër, sikur ta kishin shpuar me një thikë të hollë. Puls! po i rrihte dendur. «Ç'është kështu? Mos ndoshta nga emocioni?»

Të rrahurat e zemrës po i shtoheshin. Tani po i merrej dhe fryma. «Ç'kam kështu? Mos ndoshta nga të nxehtit që po shtohet?»

Bëri të çante përpara, po këmbët muskuloze po i ngrinin. «Mallëkim. Mos vallë filluan përsëri krizat e stërmundimshme? Po përse tani, që po përfundon gara? Durim dhe pak, o zemër...»

Po fillonte një e përpjetë. Kjo ishte e përpjeta e fundit. Po ai mezi po i ngjitej. Kodrat përreth filluan t'i rrotulloheshin, fusha po shkrihej njësh me shtëpitë që i dukeshin se po rrokulliseshin njëra mbi tjetrën.

«Edhe pak... duro edhe pak. Më fort!»

Ndjeu zhurmë biçikletash nga pas. Pastaj frymëmarrje të nxituara. E kishin arritur. Dhe tani po e kalonin. Kurse ai nuk mund të bënte asgjë për t'i kaluar.

«Si më ndodhi kështu! Mos ndoshta nuk i llogarita mirë forcat? Mos ndoshta bëra më tepër nga ç'mundja?»

Sytë po i visheshin. Një lëmsh po i mbështillej në grykë, pastaj po e mbështillte të tërin. Ata po zhdukeshin para syve të tij, ata që i kishte lënë prapa. Ja dhe rrugët e qytetit, turmat e para të spektatorëve.

— Më fort, Soni, më shpejt!

Atij i thërrisnin. Po ç'mund të bënte tani ai? Po e kalonin dhe çiklistë të tjerë.

— Soni, ç'bën kështu? Luaji këmbët... tundu!»

«Ah, qenka mister Benksi!. . . Kërkon që unë të dal i pari, që të rrit lavdinë e tij, paratë e tij!.. »

— Soni, më shpejt të urdhëroj!..

Ai pa trubull, si në mugëtirë, fytyrën e zverdhur të mister Benksit, që po e kërcënonte nga dritarja e maqinës së tij.

«Si më ndodhi ashtu... Kjo kapitje dërmuese gjatë ngjitjes... Shiu, breshëri. Muskulatura e mpirë. Pastaj mister Benksi... çaji... po, po çaji i ngrohtë... dhe papritur ai gjallërim, ajo përtëritje, që s'e kisha ndjerë kurrë... kundërshhtarët që mbetën prapa, ndërsa ngjitesha si të fluturoja!..»

— Soni ç'bën kështu? U çmende?

Mister Benksi vazhdonte ta kërcënonte. «Ah, i mallëkuari! Si nuk e kuptova që në fillim. Termosi i boshatisur. Çaji... çaji i nxehtë. . .»

Fijet e shkëputura të mendimit i ndërlikoheshin në kokën e trubullt dhe i humbisnin në pafundësi. Shtrëngoi dhëmbët, iu afrua maqinës së mister Benksit dhe i hodhi një vështrim të tmerrshëm, sa ai u drodh. Diç deshë të thotë, po humbi drejtpeshimin dhe u shemb në rrugën, ku po vazhdonin të shkisnin çiklistët e tjerë.

* * *

Vetëm mister Benksi e dinte shkakun e vërtetë të vdekjes së Soni Tomsonit. Po, kur u hap dera e sallës së autopsisë, ai iu sul kryemjekut të

turit, që dukej i zverdhur e i brengosur. Pas tij u sulën dhe disa gazetarë.

— Më thoni, doktor, vërtet ka vdekur? — pyeti me rrëmbim mister Benksi.

Doktori pohoi me kokë.

— Si është e mundur, doktor? Po ai ishte shumë mirë. Ç'i ka ndodhur? Ndonjë atak i papritur në zemër?.. — vazhdoi duke u mundur t'i japë zërit një ton sa më prekës.

— Po, mister Benks — foli doktori. — Po kjo nuk është një vdekje naturale.

Mister Benksi u zbraps. Gazetarët lëvizën.

— Ç'doni të thoni, doktor? — pyeti rishtaz mister Benksi, duke çapëlyer gojën si pa e kuptuar se për çfarë ishte fjala.

— Vdekja i është shkaktuar nga përdorimi i një doze të madhe amfetamine, që iu konstatua gjatë analizave.

— Si është e mundur, doktor!

— Bile amfetamina iu gjet dhe në analizën, që iu bë çajit të mbetur në termosin e tij. Duhet ta ketë pirë një orë para mbarimit të etapës. Ajo i ka shkaktuar një reaksion në organizëm dhe, si pasojë, vdekjen.

— Ah, maskarai! Edhe këtë e paska bërë! Kurse unë e mbaja për djalë të ndershëm... — thirri si i xhindosur mister Benksi.

Gazetarët nxituan të regjistronin fjalët e mister Benksit. Ata tani kishin një material sensorial për gazetatat e tyre. Një radiokronist i drejtoi mister Benksit mikrofonin.

— Po, — vazhdoi ai, — e mbaja për djalë të ndershëm. Unë s'kam kursyer asgjë për të. Por-

tretrin e tij po e stamvoja në një prodhim brisqesh. Nga kjo mund të humbas qindra mijë sterlina. Sepse kush do të blejë tani brisqe me portretin e këtij spekulatori, që guxon të përdorë doping? Po mirë e pësoi. Le ta mësojë tërë opinioni publik. Po ta dija se do të përdorte doping, do ta dënoja vetë. Tani unë e mohoj atë si çiklist të firmës sime, sepse jam i ndershëm, ndaj dhe vdekja e tij s'më bën aspak përshtypje. Kijeni mirë parasysh këto, zotërinj të nderuar gazetarë!

Dhe, duke thënë këto fjalë, u hodhi një vështrim krenar kryemjekut dhe gazetarëve, që po regjistronin fjalët e tij, ndërsa, përmes derës gjysmë të hapur, dukej i shtrirë në një shtrat të bardhë, trupi pa jetë i Soni Tomsonit.

[Faint, mirrored text bleed-through from the reverse side of the page, including words like "Kijeni mirë parasysh këto", "zotërinj të nderuar gazetarë", "Dhe, duke thënë këto fjalë", "u hodhi një vështrim", "krenar kryemjekut", "dhe gazetarëve", "që po regjistronin", "fjalët e tij", "ndërsa, përmes derës gjysmë të hapur", "dukej i shtrirë", "në një shtrat të bardhë", "trupi pa jetë", "i Soni Tomsonit"]

SHKURORËZIMI I KAMPIONIT

«Jo, unë nuk dua të derdh gjakun tim, sepse urrej luftën tuaj agresive në Vietnamin e Jugut».

KASIUS KLEJ¹⁾

Mister Krosbi mbase do të ishte ngritur nga tryeza për të ikur, po të mos kishte parë të futej në sallën e restorantit «Olimpia» mister Bredfordin, komentatorin e njohur të gazetës «Tribjun».

— Ku humbe kështu? — i tha me një ton qortimi. — Kam gjysmë ore që po të pres.

— Të më falësh, ke shumë të drejtë. Po ç'mund të bëj? Kështu e kanë punët e gazetës — u mundua të shfajësohej mister Bredfordi.

— Përsëri ndonjë koment?

— E kuptueshme, çfarë mund të kisha tjetër?

1) Kasius Klej, kampion absolut botëror i peshës së rëndë në boks, u dënua në maj të vitit 1967 me pesë vjet burg, 10000 dollarë gjobë, dhe iu hoq titulli kampion botëror nga Federata Ndërkombëtare e boksit, sepse nuk deshi të shkojë ushtar në Vietnamin e Jugut.

— Të lumtë, për besë! — i tha mister Krosbi duke i rrahur shpatullat. — Sot një koment, nesër përsëri një tjetër, pasnesër një bisedë në «Tribunën politike» të televizionit. S'ke ç'i thua: kjo është rruga më e sigurt për t'i fituar dollarët.

— E ç'janë dollarët e mi përpara atyre që fiton ti, mik i dashur? Habitem si mund të ma kesh zili ti, pronari i një prej fabrikave më të mëdha të pijeve freskuese.

— E, ashtu është, po konkurrencën, krizat, falimentimet, mijëra dollarët e humbur, ti nuk i llogarit?

Një copë here ata biseduan me shpoti njëri me tjetrin, u gajasën e u bënë më qejf, pasi hodhën disa kupa uiski.

Dalëngadalë salla e restorantit filloi të mbushesh me njerëz. Nga një tryezë diku aty pranë një burrë me fytyrë kuqaloshë, me sa duket gjysmë i dehur, duke marrë nëpër dhëmbë melodinë e një kënge të njohur, u ngrit dhe iu afrua xhuk-boksit¹). Sakaq në sallë kumboi zëri i Rei Çarllzit²).

— Ah, kjo është e padurueshme! Ti vjen të bësh qejf në restorant dhe gjendet një budalla, që të ngre nervat, — turfulloi mister Krosbi. — Ku e gjeti ky tani të na shurdhojë veshët me këtë qorr zezak!

1) Xhuk-boks quhen disa lloj gramafonësh të mëdhenj me shumë disqe, që punojnë, pasi klienti hedh në një kuti të posaçme një shumë të caktuar të hollash. Përdoren shumë në lokalet publike të Perëndimit.

2) Rei Çarllz, këngëtar i njohur zezak amerikan që është i verbër.

— Lere, ç'ke me të. Nuk e sheh si shkon duke u tundur andej-këndej? Pastaj Rei Çarlizi këndon shumë bukur! — tha mister Bredfordi.

— Bah, edhe ty t'i paska marrë djalli mend-të? Unë nuk i honeps fare këta zezakët, as Herri Belafonten, as Ben Kingun, Litëll Riçardsin, apo atë Luiz Amstrongun.

— Mua aq më bën, në janë zezakë, apo janë të bardhë. Çështja është se këndojnë mirë.

— Të lumtë, për besë, qenke liberal i madh! Dhe këto i thotë komentatori politik i një gazete!

Mister Bredfordi qeshi me zë të lartë pas këtyre fjalëve.

— Lavdi zotit që nuk je shefi im, se ndryshe do të më kishe pushuar në vend, — tha pastaj.

— S'e ke keq! I ke rënë më të! — u përgjegj mister Krosbi.

— Ç'bëhesh budalla! Si mendon ti, a mund të dal unë haptaz kundër zezakëve? Harrove që gazeta jonë njihet në opinion për pikëpamjet e saj përparimtare. Hë, mik i dashur, i tillë është profesioni im: tjetër të them, tjetër të mendoj.

— Edhe tani që zezakët po ngrihen e po bëjnë trubullira në qytetet tona e po kërkojnë gjoja të drejtat, që ne ua paskemi marrë me këmbë?

— Tani bile dhe më tepër — tha, duke picëruar sytë, mister Bredfordi. — Duhet të bëjmë çmos që t'i qetësojmë, të shtiremi se çdo gjë bëjmë për ta. Rreth kësaj shkrova dhe sot në komentim tim. I dashur, ti mund të jesh një kapitalist i mirë, po je një politikan i keq.

Ata përsëri qeshën me shpoti, hodhën disa kupa të tjera uiski e u gajasën. Mister Bredfordi

vazhdoi t'i fliste mikut të tij me entuziazëm, pa vënë re se ai nuk po e dëgjonte, ndërsa sytë i kishte mbërthyer në hyrje të restorantit.

— Po ç'pate kështu? — tha pastaj me habi.

— Shiko se cili hyri në restorant — u përgjegj mister Krosbi.

Mister Bredfordi ktheu kokën dhe pa në hyrje të restorantit një zezak të gjatë, shpatullgjërë, simpatik, ardhja e të cilit ngjalli kureshtje e miratim tek të gjithë njerëzit.

— O, Ralf O'Konori! — tha pa e përmbajtur habinë mister Bredfordi.

— Edhe ky është një zezak si të gjithë të tjerët — u përgjegj mister Krosbi.

— Po, është kampion i peshës së rëndë në boks, ama!

— Ta thashë një herë, është zezak si të gjithë të tjerët.

Mister Bredfordi tundi kokën.

— Ti, për besë, je një racist për t'u pasur zili. Po të jetoje në shtetet e jugut, do të ishe zgjedhur patjetër senator — i tha duke i rrahur përsëri shpatullat.

— Kështu duhet të jetë çdo amerikan i ndershëm, — ia ktheu mister Krosbi. — Pa shiko, ulet në tryezë pa e bërë qejfin qeder. Pale, po zbardh edhe dhëmbët — shtoi pastaj, kur e pa që po përshëndeste duke buzëqeshur njerëzit përreth. — Të isha padron i këtij restoranti, do ta dëboja...

— Mirëpo shiko se me sa ngrohtësi e vëshetrojnë. E respektojnë.

— Kope bagëtish! Po çmenden pas këtij lë-

kurëziju. E kanë humbur të tërë sedrën kombëtare... Si s'po del përsëri në ring një Roki Marçano¹⁾! Edhe vitet e fundit u ngopëm duke parë Fllloid Patërsonin, Soni Listonin dhe këtë...

— Po dhe këta amerikanë janë.

— Për mua janë vetëm zezakë. Së fundi le ta fitonte titullin e kampionit botëror ai Johanson²⁾, vetëm jo këta...

— Ti harron, mik i dashur, se zezakët po i japin kaq shumë sportit amerikan? Kujto të paktën medaljet e arta të atletikës së lehtë në të gjitha olimpiadat.

— Hë, unë s'do t'i futja kurrë zezakët në ekipet amerikane, sikur dhe një medalje të mos fitonim.

— Po atëhere do të fitonim përçmimin dhe urrejtjen e tërë opinionit publik botëror, siç ndodh me Afrikën e Jugut. Ç'je i marrë, ç'rëndësi ka në se medaljet e arta i sigurojnë zezakët? Çështja është se kështu ngrihet lart prestigji i Amerikës.

Në këto e sipër, tek po bisedonin, burri gjysmë i dehur me fytyrë kuqaloshë, që ngritur e po bëhej gati të dilte nga restoranti, i ndjekur nga

1) Roki Marçano, boksier i bardhë amerikan, kampion botëror i peshës së rëndë në vitet 50, që la dorezat e boksit, pa u mundur.

2) Ingemar Johanson, boksier suedez, për disa muaj kampion botëror i peshës së rëndë në boks, pasi mundi boksierin amerikan Fllloid Patërson (1961). Në ndeshjen revansh Fllloid Patërsoni e mundi dhe rifitoi titullin e kampionit botëror.

dy të tjerë që s'ishin më pak të dehur se ai. Ata kaluan përmes tryezave, duke turfulluar e qeshur, aq sa të tjerët përreth i shikonin me habi. Teksa po i afroreshin derës, në hyrje të restorantit, u duk një djalosh zezak me pamje të drujtur. Ai hodhi një vështrim në sallë dhe, kur pikasi Ralf O'Konorin, që po i bënte shenjë me dorë, u kthye drejt tij. Po në çast burri kuqalosh, gjysmë i dehur, që diç po i thoshte shokut nga prapa, duke u lëkundur, u përplas me të. Goditja që kaq e befasishme, sa kuqaloshi lëshoi një ulurimë dhe ra së prapthi.

Zezakut iu zhduk buzëqeshja në fytyrë. Ai shikoi rishtazi me ndrojtje përreth, si të kish bërë ndonjë faj dhe u lëshua drejt burrit kuqalosh, për ta ndihmuar që të ngrihej. U bë heshtje. Dëgjoheshin vetëm rënkimet e kuqaloshit, që, me sa duket, ish goditur keq.

— Më falni, — tha zezaku me gjysmë zëri, — unë pa dashje... ju e patë vetë...

— Qen i ndyrë! — klithi kuqaloshi, të cilit, siç duket, po i dilte pija. — Ku i pate sytë?

Tani ai që ngritur dhe po i afrohej zezakut.

— Zotëri, po e përsëris, gjithshka ndodhi pa dashje — tha zezaku duke mbledhur veten. — Mua më duket se ju duhet të tregoheshit më të kujdesshëm.

— Dhe shfajësohesh ti, zezak i qelbur?

— Zotëri, ju lutem mos e përsërisni më atë fjalë!

— Hë, e shikoni ç'guxim kanë marrë këta?! E kanë përgjigjen në majë të gjuhës. S'duhet lënë të shkelin në këtë lokal. Hajde, qërohu që tani së këtejmi!

— Ç'flisni, zotëri? Ky nuk është lokal i ndaluar për ne. Unë këtu kam ardhur kaq herë!..

— Qërohu të them sa pa humbur kohë! — Klithi kuqaloshi dhe e mbërtheu djaloshin zezak nga jaka e këmishës.

— Ulni duart e mos guxoni ta prekni atë — u dëgjua një zë i fortë.

Të gjithë në sallë, që po ndiqnin ç'po ndodhte, kthyen kokën dhe panë Ralf O'Konorin të ngrihej nga tavolina.

— Ç'kini me të? — tha ai duke iu drejtuar kuqaloshit, që kish mbetur si i shastisur. — Ju vetë e patët fajin!

— Ah, qenkeni ju, Ralf O'Konori, kampioni botëror! — tha kuqaloshi dhe ngërdheshi buzët. — Ç'i futni hundët në punët e të tjerëve?

— Ky është një miku im, ndaj largohuni, aq më tepër që nuk kini asnjë shkak.

— O, e shikoni? — tha kuqaloshi duke iu drejtuar shokëve që tani ishin afruar edhe më pranë. — Edhe po më jep urdhër. Dhe ku, këtu në këtë sallë! Harrove se dhe ti je si dhe gjithë këta të tjerët? Ta kesh për nder që vjen këtu midis nesh. Dije se këtë e bëjmë vetëm se je kampion.

— Ulni duart! — përsëriti Ralfi.

— Tani po më kërcënon, e shikoni! — uluri kuqaloshi dhe, duke rrëmbyer nga një tryezë aty pranë një shishe uiski, u mat ta godiste. Po në çast Ralfi i mbërtheu dorën me aq forcë, sa shishja ra në dysheme dhe u thye me një kris-më të mbytur.

U bë rrëmujë. Dy të tjerët, që ishin bashkë

me burrin kuqalosh, deshën t'i sulen Ralfit, po, tek panë që ai u bë gati të mbrohej së bashku me djaloshin zezak, u trembën, siç duket duke marrë me mend se ç'goditje do të pësonin nga grushtet e kampionit botëror.

Ata që ishin në tryezat përreth ndërhyjnë.

— Do ta kishin pësuar që të tre. Të sulesh kundër kampionit botëror!..

— Zezaku s'kishte asnjë faj. Ata ishin të pirë.

— Do të kisha dashur të plaste një zënkë. Atij do t'i thoshin boks!

— Ralfi s'duhej të ndërhynte. Ç'i duhej atij?

— Ashtu thua? Por, po të ishe në vendin e tij, do të veproje ndryshe...

Pjesa më e madhe e njerëzve në sallën e restorantit vështronin me urrejtje burrin kuqalosh, që kish vepruar në mënyrë kaq të ulët.

Mister Krosbi dhe mister Bredfordi e kishin përpirë tërë këtë skenë që ndodhi brenda pak minutash. Ata panë se si Ralf O'Konori doli nga restoranti, duke mbajtur përkrrah djaloshin zezak, ndërsa burri kuqalosh hungronte e kërkonte t'u shmangej atyre që po e mbanin.

— Për besë edhe këtë s'ma kish marrë mendja — tha mister Krosbi, që ish zbehur në fytyrë. — Po kjo, kjo është e padurueshme. Të ulet dinjiteti i një të bardhi përpara këtyre lekurëzëve! Zoti gazetar, s'do lënë me kaq kjo punë. Ja rasti më i bukur për të shkruar: «Një zezak ngre dorën kundër një të bardhi». Ç'titull i bukur për një shkrim!

Po mister Bredfordi s'po nxirrte asnjë fjalë nga goja.

— Ç'më rri kështu sikur të kesh humbur aksionet e bursës! Do të dilte një shkrim me nam. Dhe do ta pësonte ky Ralf O'Konori!.. — vazhdoi të fliste mister Krosbi.

— Të thashë një herë, ti mund të jesh një tregëtar i mirë, po je një politikan i keq, — u përgjegj, më së fundi, miste Bredfordi.

— Kurse ti, ja ku po të them, qenke një frikacak i rrallë! As për këtë nuk dashke të shkruash? Si është e mundur! Po ti vetë i pe të tëra! Apo kërkon të na mbrosh këtë zezak, sepse është kampion?

— Dëgjomë mua, unë e urrej atë jo më pak se ti, aq më tepër pas këtyre që ngjanë. S'e kam të vështirë të shkruaj. Po ç'do të dilte... Ndryshe do të kishte qenë puna, po të kishte goditur Ralf O'Konori. Po ai u tregua i zgjuar dhe shumë i matur.

— Oh, për këtë ke hall? Një gazetar i shka-thët si ti të mos dijë ta vërtisë? Pse, rrallë herë e bëni ju të bardhën të zezë dhe të zezën të bardhë?

— Ti gjithnjë rrëmbehesh. Mos harro simpatinë dhe miratimin që ka ai në opinion; mos harro pastaj si vepruan të gjithë këta në restorant. Asnjë nuk u ngrit kundër tij.

— Shkruaj, shkruaj!..

Po mister Bredfordi tundte kokën e kish rënë në të thella.

— Do të të paguaj unë sa të duash, pesëqind, njëmijë dollarë, vetëm shkruaj.

Mister Bredfordit i shkrepëtinë sytë, u për-

typ dhe, duke i shtrënguar krahun mister Kro-sbit, i tha me zë të ulët:

— Kam një ide gjeniale. Si nuk e kisha menduar më parë! Po do të ma shpërblesh ama.

— Folë, dymijë dollarë do të të paguaj!

Mister Bredfordi hodhi një vështrim të shpejtë përreth e, si të kishte frikë mos ta dëgjonte njeri, diç i pëshpëriti në vesh mister Krosbit, që pas çdo fjale gjithnjë e më tepër çelej në fytyrë.

— Po kjo... kjo ishte vërtet gjeniale. Ke të drejtë ti, i ke hak dymijë dollarët. Po thua do të pranojë gjenerali Përkins?

— Të jesh i sigurt. Këtë punë do ta zgjidh unë sa më shpejt. Në mos ngordhtë, do ta pë-sojë atje ky zezaku.

* * *

Ralf O'Konori, duke mbajtur në dorë një copë letër, u fut me rrëmbim në zyrën e sekretarit të gjeneralit Përkins.

— Ku veni! — i tha ai i habitur. — Kush ju lejoi të futeshit deri këtu!..

— Dua të takohem me gjeneralin Përkins — u përgjigj Ralfi.

— Po ai është. i zënë tani!

— I thoni që ka ardhur Ralf O'Konori, kam-pioni botëror!..

— Ju thashë, gjenerali është i zënë tani.

— Dua ta takoj patjetër!

Sekretari u orvat të ngulte këmbë, po atë çast u hap dera dhe sakaq u duk vetë gjene-rali, një burrë i hollë, i gjatë me flokë pakëz të rënë. Me ta parë, sekretari u mek.

— Aha, Ralf O'Konori! — tha gjenerali, duke u munduar t'i jepte fytyrës një pamje sa më të çelur. — Gëzohem që kam rastin të takohem me një person si ju. Urdhëroni, urdhëroni brenda!

Ai e mori Ralfin përkrahu dhe e futi në zyrën e tij, duke e lënë të shtangur sekretarin.

— Çfarë ka ndodhur? — pyeti me ton të butë, pasi i bëri shenjë Ralfit të ulej.

— Mua më thërrasin ushtar — tha Ralfi dhe i drejtoi letrën, që shtrëngonte në dorë.

— Për këtë kini ardhur? Kjo është detyrë e çdo qytetari të Shteteve të Bashkuara të Amerikës!

— E dija që një ditë do të shkoja ushtar, po jo në Vietnam.

— Ky është një nder që ju bëhet. Mendoni ç'përshtypje të bujshme do të bëjë kjo te brezi i ri: «Ralf O'Konori, kampioni botëror i boksit, shkoi ushtar në Vietnamin e Jugut. Ky është një shembull i lartë patriotik. Dhe ne do të ndjekim shembullin e tij.» E kuptoni ju se ç'do të thotë kjo? — foli gjenerali Perkins duke vënë buzën në gaz.

— Unë nuk dua të shkoj ushtar në Vietnam! — tha Ralfi, duke i shqiptuar fjalët ngadalë.

— S'e kuptoj si mund të flisni kështu! Kjo është e palejueshme, bile e dënueshme. Po mbase... si të them, mbase jeni pushtuar nga një ndjenjë pasigurie, frike...

— Jo, zoti gjeneral. Të jeni të sigurt. Unë nuk jam frikacak. Po ta donte puna të luftoja për mbrojtjen e atdheut, s'do të kurseja as gjakun tim.

— Po edhe në Vietnam ju mbroni atdheun tuaj, Amerikën, nga agresioni komunist.

— Jo, zoti gjeneral, në Vietnam unë nuk mbroj asnjë ideal të shenjtë.

— Ç'doni të thoni me këto fjalë? — shpërtheu gjenerali, ndërsa po ngrysej në fytyrë.

— Po e përsëris: unë nuk dua të shkoj uhtar në Vietnamin e Jugut, s'dua që gjaku im të derdhet kot në xhungla si gjaku i mijëra amerikanëve të tjerë.

Gjenerali Përkins u ngrit më këmbë, si të ish një kufomë e gjallë.

— Si guxoni të flisni kështu?! Ata janë herojtë e Amerikës së sotme — tha pastaj.

— Ata janë viktimat që shkuan mish për top! — u përgjegj Ralfi.

— Kjo është tradhëti, tradhëti e lartë ndaj Shteteve të Bashkuara — uluriu gjenerali, duke përplasur grushtin në tavolinë. — Këtë mund ta bëni vetëm ju, zezakët.

— Jo, zoti gjeneral, ky është thjesht patriotizëm, që duhet ta bëjë çdo amerikan.

— Pandehni se, duke qenë kampion botëror, do të kini mbështetjen e opinionit publik e nuk do të shkoni në Vietnam? Nuk e kuptoni se ne mund t'ju zbresim nga maja e Olimpikut në batak?

— Ju mund të bëni ç'të doni me mua. Po nuk do të jem unë që do të përlyhem në këtë batak, po ju, sepse marr parasysh çdo gjë dhe kurrë nuk shkoj në Vietnam.

— Kapeni këtë! — uluriu gjenerali Përkins, duke i rënë ziles. — Ky është një dezertor zezak e duhet ti dorëzohet gjyqit ushtarak!

Ai po vazhdonte të ulurinte, ndërsa në dhomë u futën disa ushtarakë që tërhoqën pas vetes Ralf O'Konorin.

— Lëshomëni! — u tha me përbuzje ai. — Unë vij vetë.

* * *

Pas disa ditësh gazeta qendrore, radiot dhe shoqëritë televizive amerikane dhanë komente dhe kronika të hollësishme rreth procesit gjyqësor kundër kampionit botëror, zezakut Ralf O'Konor, i cili u dënua nga gjykata ushtarake me pesë vjet burg, 10000 dollarë gjobë dhe iu hoq titulli kampion botëror sepse nuk deshi të shkojë ushtar në Vietnamin e Jugut.

Njerëzit lexonin gazetatat, ngrinin supet, diskutonin plot zjarr e nuk arrinin të kuptonin këtë vendim. Po shtypi e radio-televizioni vazhdonin kronikat e bujshme. Mbi të gjitha shquheshin kronikat e gazetës «Tribjun», të shkruara nga mister Bredfordi.

Mister Krosbi, që si gjithnjë shkonte në restorantin e hotelit «Olimpia», kur e takonte mister Bredfordin, e përgëzonte:

— Të lumtë, për besë! Ti je një politikan i rrallë. Meriton të shpërblehesh si jo më mirë për këtë mirësi që i ke sjellë demokracisë amerikane. Dhe tani le të pimë. Të gjitha shpenzimet do t'i paguaj unë.

Mister Bredfordi qeshte dhe e ndjente veten krenar e të lumtur për kronikat e tij, që po e bënin të famshëm e po i shtonin paratë, dhe sepse me zgjuarësinë e tij kishte gjetur mjetin për të shkurorëzuar kampionin botëror.